Afrim HOTI

Kërkime Arkeologjike

Përmbledhje me artikuj shkencorë
(2001-2021)

Archaeological Research
(Collection of scientific articles)
(2001–2021)
II



Botimet jozef, 2026

KËRKIME ARKEOLOGJIKE
Përmbledhje me artikuj shkencorë
(2001-2021)
Archaeological Research
(Collection of scientific articles)
(2001–2021)
II

Nga Afrim HOTI

ISBN e kolanës: 978-9928-942-63-0

Redaktor shkencor: Afrim HOTI

Përgatiti për shtyp: Muzeu Arkeologjik Durrës
Nën kujdesin e z. Alban Ramohitaj
©: Muzeu Arkeologjik, Durrës

Në kopertinën e parë: Tellus –Hyjnesha e Tokës
(fundi i shek. I – fillimi i shek. II mbas Kr. (Foto: A Hoti)

Botimet Jozef, 2026
ISBN: 978-9928-942-64-7

Përmbajtja / *Contents*

Parathënie / *Foreward* 5
60 vjet nga zbulimi i amfiteatrit / *60 years since the discovery of the Amphitheatre*……..7
ARTIKUJ / *ARTICLES* 19
I - Konteksti historik dhe arkeologjik mbi amfiteatrin dhe qytetin e Durrësit 21
Inquadramento storico e archeologico dell'anfiteatro e della citta di Durazzo..... 49
II - Il contributo di prof.ssa Sara Santoro allo sviluppo delle ricerche archeologiche a Durazzo..... 53
Kontributi i prof. Sara Santoros në zhvillimin e kërkimëve arkeologjike në Durrës 60
III - Të dhena mbi kulturën bizantine në amfiteatrin e Durrësit. (Gërmime të viteve 1966-2000) 75
Dati sulla cultura materiale bizantina dell'anfiteatro di Durazzo (scavi degli anni 1966-2002) 86
IV - Notizie preliminari sul rinvenimento di un deposito di grossi ragusei nell'anfiteatro di Durazzo (in collaborazione con Paolo Bobbio) 89
Informacion paraprak mbi zbulimin e një thesari monedhash raguzane (grosse) në amfiteatrin e Durrësit (në bashkëpunim me Paolo Bobbio) 103
V - Aspekte të përhapjes së krishterimit në provincën e Epirit të Ri..... 108
Aspects of the spread of early-christianity in the province of Epirus Nova 118

VI - L'Ilirico sudoccidentale nei secoli IV-VII 120
Iliria Jugperëndimore në shek. IV-VI..... 137
VII - Durrësi antiko-mesjetar dhe bregdetet e tij 140
Ancient and Medieval Durrës and Its Coasts 147
VIII - Aspekte të kulturës higjeno-sanitare në Dyrrachiumin antik 148
The hygiene and sanitary aspects in antique Dyrrachium……
IX - Zgërdheshi dhe Kruja, dy qytete të vazhdimësisë ilire-arbërore 158
Zgerdhesh and Kruja: Two Cities of Illyrian-Arbëresh Continuity 169
X - Spatheione të Dyrrahut 172
Gli spatheia di Dyrrachium 180
XI - Të dhëna arkeologjiko-historike për Dyrrachiumin gjatë shek VII-IX 187
Dati storici-archeologici per il Durrachium durante il VII-IX secolo. 199
XII - Dyrrachioni bizantin dhe territori i tij. (shek. VI-VIII) 201
Il Durrachium bisantina e il suo territorio (VI-VIII sec.)..... 211
XIII - Il patrimonio archeologico del museo e della città di Durrës 214
Trashëgimia arkeologjike e muzeut dhe qytetit të Durrësit .. 233
XIV - Harta arkeologjike e qytetit të Durrësit dhe planifikimi urban 238
La mappa archeologica della citta' di Durazzo e la pianificazione urbana
GËRMIME / *THE EXCAVATION*..... 249
XV - Dyrrachion. Gërmime 251
Dyrrachion. The excavations 251

Parathënie

Botimi i këtij vëllimi të ri mbi kërkimet arkeologjike në qytetin e Durrësit dhe prapatokën e tij, është vazhdim i përmbjedhjes me të njejtin titull, publikuar në gjysmën e parë të këtij viti.

Në fushën e antikitet të vonë dhe mesjetës, veç gërmimeve në monumente të tillë si: kështjella dhe macellumi bizantin, janë eksploruar edhe disa nekropole të peridhës mesjetare, që hedhin dritë në aspekte jetësore të banorëve të qytetit të Durrësit, gjatë kohës së ngjizjes së kulturës bizantino-arbërore

Midis artikujve, interes kanë edhe trajtesat specifike mbi Arkondinë dhe Themën e Durrësit, pak të njohura deri më sot në studimet tona arkeologjike. Përshtatjet dhe ndërtimet e reja, të kryera në godinat kristiane, që në dekadat e para të krijimit të Arkondisë, na dëshmojnë për një lidhje të ngushtë me prodhimet e plastikës dekorative arkitektonike longobarde, madje, kjo e fundit, e përfaqësuar nga ekzemplarë me vlera të larta artistike.

Është për t'u vënë në dukje se, në disa fasada dhe interiere të kishave janë inkastruar elemente të plastikës dekorative arkitektonike longobarde që i kanë ndryshuar atyre imazhin, duke i dhënë tipare të kishës perendimore. Kjo influencë konstatohet, jo vetem në arkitekturë por, edhe në praninë e bizhuterive, objekteve të qelqit, etj.

Që nga viti 2002 e në vazhdim nga realizimi i projektit: "Progetto Durrës", në bashkëpunim me Universitetin e Parmës e të Chieti-Peskarës, është bërë një punë e frytshme për përpilimin e hartës së rrezikut arkeologjik të qytetit të Durrësit. Dorëzimi i këtij studimi në organet e pushtetit lokal, ka ndikuar pozitivisht për frenimin e ndërtimeve pa kriter.

Në përputhje me tematikën e disa konferencave dhe simpoziumeve ndërkombëtare, të zhvilluara në Tiranë dhe jashtë shtetit: Parma, Chieti-Peskara, Vienë, etj., problematikat e studimit kanë qenë të ndryshme,shpesh here edhe specifike në trajtimin e tyre. Në këto rrethana është dashur edhe bashkëpunimi me studjues dhe arkeologe të tjerë të huaj nga Universitetet të Cincinatit (USA), Kembrixhit, etj. Frut i nivelit të studimëve të përbashkëta kanë qenë pjesmarrjet në simpoziume dhe kongrese jashtë hapësirës shqiptare dhe publikimet në disa revista mjaft të njohura ndërkombëtare si në: Hesperia, "Journal of Roman Archaeology", etj.

Midis trajtesave, një vëmendje të veçantë i është kushtuar botimit të artikujve që i shërbyen platëformës së re të ekspozitës së muzeut të ri arkeologjik të Durrësit. Duke qenë autor dhe drejtues i platformës shkencore të këtij muzeu, gjatë viteve 2003-2015, është punuar intesivisht për përgatitjen e materialeve në funksion të ekspozitës (faza e dytë, periudha antike e vonë dhe e mesjetës).

Si drejtues i projektit për arkeologjinë e shpëtimit në qytetin e Durrësit, gjatë viteve 2000-2007, janë organizuar rreth 30 fushata gërmimesh emergjente. Nga këto gërmime, është bërë e mundur të zbulohen dhe të vihen në mbrojtje shtetërore disa monumente të trashëgimisë kulturore të qytetit. Duke hartuar dokumentacionin e nevojshëm për këto zbulime të reja, një pjesë e mirë e rezultateve të arritura janë përfshirë në këtë botim.

Krijimi i kolanës, me përmbledhje të artikujve shkencorë, si pjesë e veprimtarisë kërkimore shkencore të Qendrës Muzeore Durrës, e ka rritur interesin për njohjen e trashëgimisë kulturore të qytetit antiko-mesjetar të Durresit. Botimi i vëllimi të katërt, besoj se nuk është i fundit, por duhet të vijojë me publikimin e veprave të tjera të kësaj gjinie

60 vjet nga zbulimi i amfiteatrit

Aty nga fundi i shek. XVII, sikundër shumica e amfiteatrove romake, edhe amfiteatri i Dyrrahut, u braktis. Ky monument është përmendur së fundmi në burimet historike të fillimit të shek.XVI, nga Marin Barleti. Që prej atëhere, nuk njihet asnjë referencë e shkruar, dhe amfiteatri, gradualisht, u zhduk nga vëmendja e studiuesve.

Marrja e gurëve gëlqerorë dhe e mermerit të amfiteatrit për ripërdorim duhet të ketë filluar nga mesi i shek.V. Fakti që kapela i shpëtoi marrjes së materialit ndërtimor, flet për lënien e kësaj zone, si një hapësire kulti nga periudha e antikitetit të vonë e deri në shek.XVII.

Për të gjetur ndonjë mbetje të monumentit, erdhi me librin e Barletit në sqetull, edhe arkeologu i njohur britanik Artur Evans (maj 1877), por nuk konstatoi asnjë gjurmë të strukturave të tij.

Të dhënat e vetme që kishte arkeologu Vangjel Toçi për ekzistencën e amfiteatrit, ishin dy pllaka që paraqisnin ndeshje gladiatorësh, të zbuluara nga L.Heuzey dhe H. Daumet (prill 1861).

Gjashtëdhjetë vjet më parë, në truallin e lagjes "Kala", kazma e arkeologut të shquar Vangjel Toçi, ra në gjurmët e Amfiteatrit, ndërkohë që i gjithë qyteti, por, edhe mbarë komuniteti kulturor shqiptar përjetoi një event të rëndësishëm. (Fig.1)

Gjashtëdhjetë vjet më parë, bota kërkimore arkeologjike, jo vetëm ajo shqiptare, por edhe mbarë europiane, përjetoi një ngjarje të veçantë. Epigrafisti i njohur francez, Lui Robert, që erdhi personalisht për të vizituar amfiteatrin, "zbulimet arkeologjike në Durrës, ia atribuoi zellit dhe veprimtarisë të Vangjel Toçit". ("Bull. Epigraphique", 1970, fq. 396-398)

Një pjesë e opinionit shkencor të asaj kohe e quajti "të pamundur" që, një arkeolog të zbulojë një nga amfiteatrot më të mëdhënj të botës antike. Por, falë vullnetit të tij dhe të punës së palodhur të stafit të muzeut, arkeologu Vangjel Toçi, mundi të përpunojë metodat për gërmimin, studimin dhe propogandimin e këtij monumenti.

Për zbulimin e amfiteatrit, gjatë viteve të gërmimit, dhanë ndihmesë specialistë të përzgjedhur, arkeologët: Fatos Tartari, Hava Hidri, Halil Myrto e Ilia Toçi; kimisti-restaurator Frederik Stamati, specialistë të monumenteve të kulturës: Fabian Miraj, Spiro Koçi e Fredi Shuko; restauratorët skulptorë: Nelo Lukaçi, Gravil Priftuli e Qazim Kërtusha; piktorët: Nikolet Vasia, Liljana Çika e Myrvete Dajlani; fotografi Agim Kavaja dhe punonjësit e muzeut: Qamile Zguro, Xhevdet Haxho, etj. (Fig. 2, 3, 4)

Historiku i gërmimëve.

Në maj të vitit 1966, pasi arkeologu Vangjel Toçi bëri të mundur identifikimin e monumentit, ai i drejtoi gërmimet, (1966-1980), duke lëvizur një numër të madh shtëpiash moderne dhe otomane, nga hapësira që mbulonte shkallaren dhe pjesën më të madhe të galerive të anës veriore e perëndimore të amfiteatrit. Befasues ishte zbulimi i Kapelës kristiane, ku ruhej i vetmi mozaik mural në Shqipëri. Ndër materialet arkeologjike të gjetura në këto gërmime ishin: Qeramika, qelqi, një thesar me monedha bizantine dhe objekte të tjera.

Gërmimet e mëtejshme nga viti I983 deri ne vitin 2000 janë realizuar nga Lida Miraj. Këto fushata përfshijne gërmimet në pjesën perëndimore të galerive dhe zbulimin e shkallareve e të galerive të pjesës verilindore. Në këtë anë të strukturave u bë e mundur edhe zbulimi i kishës B. (Fig. 2)

L.Miraj ka publikuar një analizë të gjatë të arkitekturës së amfiteatrit, duke nxjerrë në pah, pozicionin dominues që zinte ky monument në planin urban të qytetit.

Ndërkohë, Moikom Zeqo, studjoi dhe publikoi afreskun e kishës B.

Pas gërmimëve për hapjen osteotekës, të përshtatur pranë Kapelës, materiali skeletor, u publikua nga Haki Bllaca dhe Aleksandër Dhima.

Pjesa më e madhe e varreve të zbuluara në arenë dhe përgjatë dyshemeve të galerive nga Vangjel Toçi dhe Lida Miraj, janë gjendur pa inventar.

Gërmimet sistematike në amfiteatër të nisura në vitin 2004 nga misioni arkeologjik italo-shqiptar, kanë vazhduar pa ndërprejrje deri më sot.

Në përbërjen e stafeve (në vitet 2004-2014, me bashkëdrejtues S.Santoro dhe A.Hoti dhe, në vitet 2017-2026, S. Antoneli – E.Metalla) janë përfshirë një grup specialistësh italo-shqiptarë (arkeologë, arkitektë, topografë, gjeodetë, gravimetristë, etj.). Fushatat e gërmimëve, të përqëndruar në pjesën jugore të monumentit, kanë evidentuar hyrjen jugore të amfiteatrit, strukturat e galerive të sipërme, rrënojat e një ambjenti të kohës antike të vonë dhe disa varre të periudhës mesjetare. (Fig.5)

Rilevimi arkitektonik

Dokumentacioni i trashëguar nga autori i zbulimit përbëhet nga vizatime, midis të cilave dhe një planimetri e zonës përreth kapelës A, në shkallën 1:20. (Fig.6)

Një rilevim për monumentin ka publikuar Koço Miho në librin e tij "Amfiteatri i Durrësit", botuar më 1984.

Planimetria e kompletuar e amfiteatrit është publikuar nga Lida Miraj më 1986, që përfshin strukturat e zbuluara deri në

atë kohë. Një plan i detajuar i zonës rreth kishës A, është publikuar nga Reshat Gega më 1998.

Planimetri tjetër, duke përdorur Total Station, në shkallën 1:50, është realizuar nga Kim Bowes. (Projekti "Amfiteatër 2002" i QNASH.)

Me shumë vlerë kanë qenë edhe punimet rilevuese, ato topografike, të gjeodezisë, të gravimetrisë etj. të realizuara nga stafi i misionit arkeologjik italo-shqiptar, duke plotësuar një dokumentacion që kish munguar deri më sot.

Synimet restauruese.

Në kuadër të projekti "Amfiteatër 2002" i QNASH, specialisti Roberto Nardi nga ICROM, i cili ekzaminoi mozaikët dhe afresket e kishës A, arriti në përfundimin se niveli në rritje i lagështirës në kishë, ka shkaktuar një kristalizim të madh të kripës, çka i rrezikon mozaikët dhe afreskët.

Konstatimi tjetër i tij ka të bëjë me rrezikun e madh që i vjen amfiteatrit nga rrjedhja e ujrave sipërfaqësore që zbresin nga kodra dhe ai i rrjedhjeve nëntokësore. Nga një vlerësim paraprak, duket që amfiteatri paraqet një mikrozonë hidrologjike, muret e tij vuajnë nga niveli i lartë artificial i lagështirës. Raporti i tij mbyllet me rekomandimin që të hartohet një projekt drenazhimi për zbrazjen e ujrave të ndenjura të amfiteatrit në kanalizimet e sotme, përreth zonës së amfiteatrit.

Mbresa dhe episode

Kam patur privilegjin ta njihja personalisht arkeologun Vangjel Toçi dhe të ndiqja gërmimet e tij. Kjo për faktin se, gjatë viteve 1968-1972, kur kryeja studimet e larta për histori në Universitetin e Tiranës, gjatë seminareve në auditore, më kërkohej të jepja informacione rreth fushatave që ishin ndërr-

marrë për zbulimi i këtij monumentit madhështor të arkitekturës romake.

Në kujtim të atyre viteve, unë kam parë disa rezultate dhe dëgjuar nga bisedat me Vangjel Toçin, informacione të ndryshme

Sipas Vangjelit, para zbulimit, te banorët rrëfeheshin gojëdhëna të ekzistencës të strukturave të vjetra dhe të nënkalimeve që ekzistonin nën shtëpitë e tyre.

Një bisedë interesante me të ishte fakti se si ai rastësisht zbuloi strukturat e amfiteatrit!

Pas një dite me rrebesh të dëndur shiu, në oborrin e një banese të lagjes Kala, papritmas, u gëlltit dhe ra thellë në një gropë-humnerë një trung fiku, Ishte nuhatja intuitive e arkeologut Toçi, që hamendësoi, këtë gropë gjigante, me një nga hapësirat e segmenteve të galerive.

Ka edhe episode të tjera që tregojnë mbi personalitetin e Vangjel Toçit. Kështu, gjatë atyre viteve, në çdo themel që hapej në qytet, qarkullonte gojë më gojë shprehja e zakonshme popullore: "Kujdes ruhuni, se po vjen Vangjeli!"

Vangjel Toçi i publikoi rezultatet në një artikull në Revistën "Monumentet" Kërkesat e kohës për botimin e amfiteatrit dhe materialeve të gjetura ishin të mëdha. Ai kishte besim se, për këtë vepër të arkitekturës romake, do të përgatiste për botim një vëllim të veçantë. Megjithë njohuritë e tij arkeologjike, shfrytëzimi i literaturës të specializur për studim, ishte një premisë për të realizuar një publikimin cilësor të amfiteatrit.

Ardhja e një ftese (një bursë 6-mujore), si shenjë mirënjohje dhe besimi, e akorduar nga një Institucion prestigjoz arkeologjik i huaj, ishte një gëzim i madh për të. Por, fatkeqësisht, burokracitë dhe egot e sëmura, e penguan atë, çka e frenuan në një farë mënyre për studimet e mëtejshme.

Interesant ishte edhe fakti se si një zbulim i një objekti kulti u bë shkas për thyerjen e tabusë së ndalimit të fesë. Në Shqipërinë e atëhershme ateiste besimtarëve u ishte privuar e drejta e ushtrimit liturgjik, por kapela bizantine, e zbuluar në amfiteater, u kthye në një vend peligrinazhi, ku turistë kristianë dhe jo vetëm, pas vizitës, rregullisht, linin qirinj në ambjentet e kishës

Autoritetet shtetërore të atëhershme i inkurajuan dhe i mbështetën me fonde financiare gërmimet arkeologjike. Shtetëzimiet dhe prishja e shtëpive, pronë private, u bënë në zbatim të ligjit të vitit 1961 "Mbi nëntokën muze të qytetit të Durrësit", në bashkëpunim me autorin e zbulimit, dora-dorës me shumë maturi e kujdes. Për të plotësuar kërkesat e zgjerimit të gërmimeve, u prishën vetëm ato shtëpi që ishin brenda segmentit perimetral të amfiteatrit. Jashtë këtij perimetri, qoftë edhe disa metra distancë, banesat e qytetarëve nuk u preken.

Sot, pas 60 vjetësh

Amfiteatri është shndërruar aktualisht në një nga sitet më të begatë turistikë të vendit tonë, një nukël kulturor ndër më të vlerësuarit në segmentin turistik Tiranë-Durrës

Tanimë, 60 vjet më vonë, përveç gërmimëve arkeologjike, që po vazhdojnë, amfiteatri ka mbetur në udhëkryqin e projekteve menaxhuese që, ende nuk po gjejnë terren për t'u zbatuar. Një projekt që të trajtojë problematikat e konservimit, restaurimit, rijetëzimit dhe të integrimit të strukturave të këtij monumenti, në harmoni me arkitekturën modern, ku të përfshihen, institucione dhe specialistë vendas dhe të huaj, që kanë dhënë kontribut për zbulimin e studimin e amfiteatrit, do të ishte një zgjidhje e dobishme.




Fig.1.Vangjel Toçi me stafin e gërmimeve në amfiteatër. Viti 1969. (Foto A.Kavaja).




Fig.2. Gërmime pranë Kapeles bizantine. Vangjel Toci me stafin e tij. Viti 1969. (Foto A.Kavaja).



Fig.3. Vangjel Toçi dhe asistenti i tij, Ilia Toçi, në një nga galeritë e amfiteatrit – Viti 1969. (Foto A.Kavaja).




Fig 4. Pamje nga gërmimet në amfiteater. Përballë kuadrateve, Vangjel Toci. Viti 1968. (Foto A.Kavaja).



Fig.5. Gërmimet arkeologjike italo-shqiptare të vitit 2005 (Foto A. Monti).




Fig.6. Një nga planimetritë e gërmimëve në amfiteatër. Viti 1971

ARTIKUJ
ARTICLES

I

KONTEKSTI HISTORIK DHE ARKEOLOGJIK MBI AMFITEATRIN DHE QYTETIN E DURRËSIT[1]

I. Vështrim historik dhe arkeologjik

Që nga ndërtimi e deri në fazat e fundit të transformimit gjatë epokës otomane, amfiteatri iu nënshtrua një procesi të gjatë duke ndjekur rrjedhat e evolucionit historik të qytetit[2]. Brenda këtij monumenti të madh, si në kohën e zbulimit të tij, ashtu edhe në gërmimet pasuese, është pasqyruar një stratigrafi e larmirtë dhe një material i bollshëm arkeologjik.

Pasuria e materialit në fazat e pasbraktisjes lidhet me vend-ndodhjen qëndrore të monumentit, pranë portës kryesore të qytetit, në një lagje që, me shumë gjasa, ka shërbyer si për aktivitet tregtar ashtu edhe për qëllime banimi.

Gërmimet e viteve 2004-2005 zbuluan, përveç strukturave të monumentit, një situatë stratigrafike komplekse, ndryshe nga ajo që ishte vërejtur në fushatat arkeologjike të viteve të

[1] Marrë si tekst nga: HOTI, A. -Inquadramento storico e archeologico dell'anfiteatro e della citta Dyrrachium, ("Dyrrachium I, Anfiteatro di Durazzo. Studi e Scavi 2004-2005, Annali Scuola Archeologica Italiana Atene "LXXXIII, serie III, 5, Tomo II, 2005, pp. 723-731 ISSN: 0067-0081723-731

[2] Zbuluesi i amfiteatrit, V. Toçi, në komunikimin e tij të parë për zbulimin, e daton monumentin midis fundit të shek. I dhe fillimit të shek. II: TOÇI 1971, 40-41. Mbulimi i plotë e monumentit, sipas hulumtimëve tona mund të ketë ndodhur në fundin e shek. XVI: BOWES-HOTI 2003.

mëparshme, të përqendruar veçanërisht në zonën e arenës, ku njësitë stratigrafike ishin të përziera.

Ndryshimi i stratigrafisë në sektorët e gërmimeve të fundit, përveç të tjerave, edhe me aluvione të spostuara nga shpati i kodrës, me sa duket, nga puna intensive ndërtimore e gjatë dy shekujve të fundit në këtë zonë të qytetit.

Në gërmimet e V. Toçit, të kryera kryesisht në pjesën veriore të tij, disa gjetje që i atribuohen periudhës së vonë helenistike, kanë qenë sporadike dhe mund të interpretohen si rezultat i transportit së dherave nga sheshi i ndërtimit të monumentit ose nga zhvendosja e strukturave shkëmbore nga shpatet e kodrës mbi të cilën mbështetej monumenti[3].

Fazat e transformimit të seksionit jugor të amfiteatrit, (më pak i ruajturi, që është duke u gërmuar), lidhen me historinë e vetë qytetit nga periudha paleobizantine e në vijim. (Fig. 1)

Periudha antikitetit të vonë ishte harku kohor i një impulsi e shkëlqimi të madh për Dyrrhachiumin, një qytet i denjë për të qenë një rezidencë mbretërore, aq sa, në vitin 533, perandori Justiniani I i ofroi mbretëreshës ostrogote, Arnalasuntha mikpritje në shtëpinë më të bukur të asaj kohe[4].

Materialet nga kontekstet stratigrafike të mëvonshme hedhin dritë mbi marrëdhëniet e Dyrrahut me qytetetet Adriatikut e të Jonit dhe kontaktet me Afrikën e Veriut.

Me gjasa, pas ndalimit të lojërave me gladiatorë, në amfiteatrin e Dyrrachiumit, gjatë mbretërimit të Theodosit, filloi zhveshja sistematike e pllakave që mbulonin shkallët e caveas, të dyshemesë së arenës dhe të galerive, si dhe ndërtimi i varreve

[3] Këto janë një numër fragmentesh qeramike, disa prej të cilave janë prodhime lokale, që datojnë midis fundit të shek. II dhe fillimit të shek. I para Kr.

[4] PROC., B. Goth., V, II, 24 (Loeb).

dhe objekteve të kultit të krishterë, në galeritë e brendshme dhe në arenë.




Fig. 1. Një nga hyrjet e amfiteatrit (Foto: A. Hoti)

Ky proces i transformimit nga monument për spektakle në një qendër fetare dhe funerale, ndodhi gradualisht, gjatë një periudhe të gjatë kohore, një dukuri e zakonshme, sikundër ndodhi edhe në amfiteatrot e tjerë romakë të Mesdheut. Procesi

i transformimit shkon krah për krah me shdrimin e Dyrrahut nga një qytet pagan, provincial romak, në një qytet tipik kristian-bizantin

Por, fillimi i këtij transformimi ende nuk është plotësisht i qartë. Nëse marrim në konsideratë përmbajtjen e një mbishkrimi në latinisht, (kombinuar me disa shkronja greke *'biling'*, çka vërehet në rajonin e Ballkanit apo në monedhat e kësaj periudhe[5]) në një gur varri të datuar në gjysmën e dytë të shek. V, mund të supozojmë, se gjatë kësaj periudhe, varrimet e para të krishtera, ishin shfaqur në arenë dhe se të varrosurit këtu, i përkisnin aristokracisë së qytetit. Megjithatë, ky datim ende nuk është e sigurt: ky gur me mbishkrim, gjetur në kapelën A, mund të jetë vendosur aty në një kohë të mëvonshme, si një ripërdorim.

Kapela A, në anën perëndimore të amfiteatrit, ndoshta është përshtatur në të njëjtën kohë me nekropolin e fundit të shek. V, por datimi i kishëzës, si në aspektin e structures, ashtu edhe të dekorimit, është i diskutueshëm[6].

Në Kapelën B, e ndërtuar në një kohë më të vonë, në anën lindore, përballë kapelës A, varrimet datojnë në peridhën otomane, në çerekun e parë të shek. XVI. Ndërhyrjet e fundit përshtatëse në strukturat e amfiteatrit, ende të dukshme si rrënoja, datohen në mesin e shek. XVII, ku në perimetrin perëndimor të strukturave të sipërme. disa kthina, u përdorën për ushtrinë osmane

II. Periudhat dhe fazat në amfiteatër

Duke kombinuar të dhënat nga kërkimet e mëparshme, gërmimet italo-shqiptare të viteve 2004-2005, dhe informacionin historik dhe arkeologjik mbi qytetin, mund të për-

[5] MIRAJ 1991, 273-274.
[6] BOSCHETTI - CORRADI et al. c. s.

caktojmë gjerësisht periudhat e evolucionit të monumentit dhe hapësirës territoriale urbane, të ndarë në periudha e faza.

1. Periudha romake (fundi i shek. I - fundi i shek. IV pas Kr.) përputhet me harkun kohor nga ndërtimi i amfiteatrit, deri në ndalimin e lojërave me gladiatorë. Kontekstet stratigrafike të kësaj periudhe u formuan gradualisht.

Faza e parë: fillon me ndërtimin e amfiteatrit (midis fundit të shek. I dhe fillimit të shek. II pas Krishtit) dhe përfundon në vitin 286 pas Kr.[7], me përfshirjen e Dyrrhachiumit në ndarjen e re administrative të Dioklecianit.

Nga gërmimet e V. Toçit, në fakt, janë gjetur monedha të perandorëve Hadrian dhe Antoninus Pius, duke supozuar se lorjat me gladiator organizoheshin gjatë atyre mbretërimeve. Në këtë fazë, përveç amfiteatrit, u ndërtuan edhe ndërtesa të tjera publike të rëndësishme (Termat, Ujësjellësi etj.), (Fig. 2) të cilat ndryshuan pamjen e qytetit si rezultat i transformimeve të rëndësishme ekonomike që solli rritja e prodhimit dhe e tregtisë vendase. Një dukuri e tillë dëshmohet arkeologjikisht nga prania e konsiderueshme e amforave të transportit (Dressel 17 dhe 20 dhe Beltran IIa etj.) [8]

Punishtet e qytetit prodhonin tjegulla dhe tulla, dhe ndoshta enë tavoline (imitime të qeramikës italike sigillata); ndërsa firmat italike të llambave, si Felix, Fortis dhe Festi, kishin degë në Dyrrachium. (Fig. 3) Tregëtia e qytetit u orientua drejt Adriatikut verior dhe në qendrat të Egjeut (qeramikë, qelq, etj).

Qyteti duket se ka qenë pjesë e një rrjeti kontaktesh të qëndrueshme edhe me qendrat e Azisë së Vogël, ishujt e Egjeut, Atikën, Afrikën e Veriut, Gadishullin Iberik[9] dhe sigurisht me

[7] HOTI 2003a, 27.

[8] SHEHI 2003, 212-216, TARTARI 2004, 43-97.

[9] SHEHI 2003, 214. Enët prej qelqi imitojnë modele italike (për kremëra) ose forma të qeramikës sigillata që përdoren si urna. Gjithashtu, me origjinë ko-

qytetet përgjatë Rrugës Egnatia (Scampis, Lychnid, Thesaloniki, Amfipoli, Pella, Edessa, Filipi, etj.).



Fig. 2. Pamje e pjesëshme e Termave Publike, shek. I mbas Kr.
(Foto: A. Hoti)

Prania e tregtarëve romakë në Dyrrachium, përveçse e përmendur në letrat e Ciceronit është, është dokumentuar epigrafikisht në një stelë funerare të tregtarit nga Ankona (Γάιος Καισίος, Αγοχουνσίτη)[10]. Epigrafia funerare dëshmon gjithashtu për një grup qytetarësh të rangjeve të ndryshme shoqërore: magjistratë dhe zyrtarë të nivelit të lartë, monumentet funerare

rintiane, të gjetura edhe në Apolloni, Butrint dhe Bylis, janë llambat që mbajnë vulat KARPOU, POSFOROU, KALISTOU dhe FLAVOU.

[10] L'arte albanese, 88, n° 355.

të të cilëve shpesh porositeshin nga tregje të largëta (Athinë, Romë, Prekones, etj.).



Fig. 3. Furrë për pjekje qeramike, shek. I mbas Kr. (Foto: A. Hoti)

Në këto mbishkrime përmenden edhe profesionistë të ndryshëm: shkrimtarë, muzikantë, rrobaqepës, zdrukthtarë, etj. Në qytet kishte shumë të huaj, që vinin, nga Dalmacia, Azia e Vogël ose Lindja, midis të të cilëve, dhe ata që praktikonin kultin e Mithras. Në ambjentet e qytetit, përveç ilirishtes, fliteshin shumë gjuhë, ndërsa latinishtja zyrtarja ishte më e përdorshmja.

Faza e dytë (fundi i shek. III - fundi i shek. IV pas Kr.). Me reformën administrative të Dioklecianit, Dyrrachium u bë qendra kryesore e provincës Epirus Nova dhe mori një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zonën e Adriatikut të Poshtëm dhe atë Joniane.

Zbulimet e fundit të mbetjeve të ndërtesave të shek. IV, të elementëve të dekorimit arkitektonik dhe produkteve artiza-

nale[11] nga inventari i varreve, tregojnë nivelin e zhvillimit të kësaj periudhe[12].

Gjatë mbretërimit të Kostandinit të Madh dhe periudhës që pasoi atë (313-370), u shfaqën varret e para të krishtera të tipit dhomëza me mure të pikturuara nga brenda, me simbole të krishtera.

Nga fillimi i shek. V, u përdorën edhe sarkofagët e zbukuruar me simbole të krishtera, disa prej të cilëve me mbishkrime greke.

Në nekropolet e kësaj periudhe, ndërtohen gjërësisht varre me çati tjegullash, por edhe varre me gropë të thjeshta[13]. Simbolet e krishtera shfaqen gjithashtu në objektet e inventarit të varreve: fibula të tipit kryqiformë (fundi i shek. - fillimi i IV pas Kr.), llamba terrakotë, të zbukuruara me Chrismon (shek. IV), por edhe tokëza, gjerdanë dhe unaza. Enët afrikanë sigillata të importuara midis viteve 280 dhe 350, dhe imitimet e tyre, paraqisnin gjithnjë e më shumë elementë dekorativë ungjillorë, ndërsa në një kupë paraqitet imazhi ballor i Krishtit[14].

Inventarët e varreve përfshijnë gjithashtu monedha, vegla pune dhe armë. Këto të fundit janë zbuluar gjithashtu edhe në rrethina të qytetit, në varrezat rurale të Mali i Robit, Shkallnur, Koxhas, Gosë e Vogël, etj. [15].

2. Periudha Bizantine (fundi i shek. IV - fillimi i shek. XIV). Nga studimi i të dhënave arkeologjike dhe burimeve historike, është e mundur që kjo periudhë e gjatë të ndahet në disa faza:

Faza e parë (fundi i shek. IV - fundi i shek. V): nga mbretërimi i Theodosit I (379-395) deri në atë të Arkadit I (485-491).

[11] TARTARI 2004, 100
[12] HOTI - METALLA - SHEHI 2004 b. 1981, 119.
[13] HOTI 1996.
[14] HOTI 1996.
[15] HOTI 1996; TARTARI 2004.

Kjo është fazë e re ndërtimesh: pas katastrofës së tërmetit të vitit 346, u ngritën fortifikimet në shpatin verior[16], u bënë ndërtime të reja në qendër[17] dhe u rindërtuan ndërtesa të tjera të dëmtuara nga tërmeti[18].

Pranë amfiteatrit dhe përrreth qendrës të qytetit, janë zbuluar elementë arkitekturorë dekorativë (kolona, kapitele imposte e plinta të dekoruara), të cilat mund t'i përkasin godinave të adhurimit, ndoshta një grupi ndërtesash peshkopale[19]. Në këtë zone janë zbuluar monedha perandorake bizantine, amfora nga Samos, llamba nga Thasosi, qeramikë nga Fokea dhe qelq, kryesisht të importuara.

Faza e dytë (fundi i shek. V - fundi i shek. VI). Eshtë faza që përfshin mbretërimin e Perandorit Bizantin Anastasius I (491-518), i cili lindi në Dyrrachium, (fig. 4) dhe Justinianit I (527-565). Megjithëse relativisht e shkurtër, eshtë një fazë zhvillimi intensiv për qytetin dhe territorin e tij. Situata e re e krijuar nga migrimi i popujve i detyroi të dy perandorët të ndërmerrnin një program të madh fortifikimesh. Për më tepër, ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti i vitit 522 pas Kr. u rindërtuan ose u restauruan. Dyrrachium (tanimë i quajtur Dyrrachion) mori pamjen të një qyteti tipik të krishterë[20], i fortifikuar dhe me një grup ndërtesash peshkopale.

Fortifikimet, me perimetër 4, 400 m dhe lartësi 12 m, u ndërtua në përputhje me parimet e arkitekturës bizantine[21] Ato rrethonin qytetin, duke përfshirë 120 hektarë, të ndarë në tre

[16] Pjesa shtesë e fortifikimit "Kepi Pali" ka të ngjarë t'i përkasë gjithashtu kësaj faze: KARAISKAJ 1981, 119.
[17] HOTI 1996. Ndërtimet e kësaj kohe i kanë themelet 1. 20 m. mbi nivelin e termave romake.
[18] SANTORO 2003 b, 191-198; HOTI-METALLA - SHEHI 2003 b, 514-519.
[19] HOTI 1996.
[20] I njëjti transformim ndodhi edhe në qytete të tjera paleokristiane në provincë, si Bylis dhe Scampis: HOTI 1997 b, 107-108.
[21] GUTTRIDGE - HOTI - HURST 2001, 395-402; HOTI 2005, 53.

pjesë: kështjellën e sipërme, kështjellën e poshtme dhe qendrën urbane me ndërtesat peshkopale.



Fig. 4. Perandori Anastasi I, skicuar nga një monedhë e viteve 507-512 (Skicoi: M. Dajlani)

Muret e fortifikimit (fig. 5) u ndërtuan me tulla dhe llaç gëlqereje të përzier me copëza tullash, një teknikë e njohur kjo, në murin e jashtëm të Kostandinopojës, ndërtuar gjatë mbretërimit të Anastasit I [22].

Kishat dhe bazilikat paleobizantine paraqesin një gamë të pasur elementësh dekorativë arkitektonikë, të importuar direkt nga atelietë e Prokonnesit[23]. Ato përfaqësohen me kisha të

[22] Burimet raportojnë se, gjatë mbretërimit të Anastasit I u ndërtuan 66 vepra ndërtimore, por kalaja e Dyrrahut dallohet ndër ndërtimet më të rëndësishme ushtarake në hapësirën bizantine: CHRYSOS, 1981, 98. Përveç monogrameve të Anastasit I, në muret fortifikuese të qytetit janë gjetur tulla me monogramet e Justinianit I, duke dëshmuar se, edhe ky perandor ndërhyri në ndërtim: HOTI - KOMATA 2004, 21-22.

[23] HOTI 2005, 56.

thjeshta me një nef dhe një absidë, siç është kapela e amfiteatrit, dhe bazilikat (Durrës, Arapaj, Gjuricaj) [24].




Fig. 5. Kulla C, shek. VI (Skicoi: M. Dajlani)

Në nekropolet e krishtera të kësaj faze, varret janë të stilit kapuçin ose varre të thjeshta. Praktika e përfshirjes të sendeve në varr është e rrallë dhe mjaft e kufizuar për sa i përket materialeve (unaza dhe tokëza) [25].

Për portet e Epirus Nova, kjo ishte një periudhë komunikimesh të shumta tregtare thuajse në të gjithë qendrat e mëdha portuale të Mesdheut[26], çka dëshmohet nga monedhat peran-

[24] HOTI 2005, 54-55.
[25] TOÇI 1971.
[26] Gjatë kësaj faze, rrugët detare ishin: Korkyra-Patra-Korint-Dyrrahun-Brindisi-Otranto; Dyrrhachion-Olcinium-Salona, HOTI - KOMATA 2004.

dorake bizantine[27], qeramika egjeane dhe palestineze, qelqi i importuar, etj. [28]

Faza e tretë (shekujt VII-VIII). Krahasuar me fazat e mëparshme, kjo është një kohë me zhvillime të kufizuar, andaj dhe ato pak ndërtime të e reja modeste, nuk e ndryshuan fizionominë e qytetit[29]. Shumica e ndërtesave nga periudha e vonë antike vazhduan të funksiononin edhe në fillim të mesjetës së hershme: muret bizantine të qytetit, Macellumi, (Fig. 6) kapela e amfiteatrit, kisha e Shën Anargyroi (Kozmai dhe Damiani), e përmendur qysh në mbretërimin e Anastasiusit I dhe, së fundmi, në vitin 714. [30]

Ashtu si në pjesën tjetër të perandorisë, edhe në Dyrrah, në shek. VII, vihet re qarkullimi i kufizuar i monedhës, duke reflektuar krizën e përgjithshme të sistemit. Via Egnatia, duke qenë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të sllavëve dhe avarëve, thuajse kishte pushuar së qeni si arter i tregtisë perandorake. Në këto rrethana pati një tkurrje të qartë në sistemin e shkëmbimit dhe qarkullimit të monedhës në të gjithë territorin jugperëndimor të Bizantit[31] Pavarësisht kësaj, qyteti vazhdoi të mbijetojë. Siç dëshmojnë gërmimet arkeologjike: qyteti u prek më

[27] HOTI - MYRTO 1991. Numri i madh i monedhave të zbuluara tregon impaktin e tregtisë dhe gjithashtu faktin se qyteti duhet të këtë qenë i sigurt për të mbrojtur pasuritë e tij monetare, Andaj dhe mbretëresha gote Arnalasunta, e zhvendosi thesarin e saj në Dyrrah (përkohësisht) të sjellë nga Ravenna: CHRYSOS 1981, 98.

[28] HOTI - KOMATA, 2004

[29] Në qytetin e Dyrrhachion dhe qytete të tjera mesjetare (Lissus, Kanina, Pulcheriopolis, etj.), duke filluar nga shek. VII është vënë re se për rindërtimet, por edhe për ngritjen e ndërtesave të reja, prodhimi i materialeve të ndërtimit ishte shumë i kufizuar. Në këto rrethana pati një ripërdorim të gjerë të tyre: HOTI 1999.

[30] HOTI 1996.

[31] Tkurrja, e përkeqësuar nga situatat rajonale, filloi të vihej re në fund të mbretërimit të Justinianit I dhe arriti kulmin e saj nën mbretërimin e Konstancit II (641-668) dhe deri në fund të shek.VII: HOTI-MYRTO 1991.

pak nga kriza e migrimi i popujve, duke u integruar më lehtë në formacionet e reja politike dhe institucionale të krijuara rishtazi nga perandoria bizantine.



Fig. 6. Maçelum, fillimi i shek. VI mbas kr. Foto e vitit 1988 (Fotograf: Agim Kavaja).

Në fillim të shek. VIII, ndoshta më herët, administrimi i rajonit të Dyrrahut ishte organizuar sipas modelit të ri "Arkondia e Dyrrahut", Krahinë Autonome nën juridiksionin e së cilës ishin edhe rrethinat e afërta. Në disa burime bizantine Arkondia e Dyrrahut përmendet si një ndarje administrative, më e rëndësishmja në fasadën bregdetare të Adriatikut lindor.

Porti i Dyrrahut, gjatë kësaj kohe, ishte baza më e madhe ushtarake e flotës bizantine në Adriatik. Arkondia e Dyrrahut, një territor i kufizuar me kufij konvencionalë, përbëhej nga

qytetarë vendas, tashmë "proto-arbërorë". Për shkak të pasigurisë nga “Dynja e Popujve”, banorë nga zonat përrreth ishin vendosur rishtaz në Dyrrah, për një jetë më të sigutë[32].

Vendbanimi i fortifikuar (i ashtuqujtur "Castra") u përhap edhe në Arkondinë e Dyrrahut: si një formë e reduktuar e një qyteti të mbyllur brenda Akropolit, fenomen ky, që ndeshet edhe në zonën e Egjeut (Amfipoli, Cristoupolis)[33].

Pavarësisht këtyre tkurrjeve, hapësinore dhe demografike, qytetet të Arkondisë (Croia, etj), vazhduan të importonin produkte bizantine, jo vetëm nëpërmjet trafikut detar, por edhe në segmente të shkurtëra rajonale, degë të Via Egnatia)[34].

Nga tregjet perandorake vinin stoli të ndryshme: fibula, tokëza, gjerdanë, e prodhime të tjera të argjendarisë tipike ballkano-bizantine[35].

Faza e katërt (shekujt IX-XI). Roli i qytetit u rrit pas themelimit të Themës me të njëjtin emër (811-815). Pozicioni i favorshëm gjeografik i rajonit Arbanon, ripërdorimi i Via Egnatia, forcimi i kontakteve me vendet perëndimore dhe rishfaqja e monedhës bizantine[36], bënë të mundur një fazë të re zhvillimi.

---

[32] Nga aktet e koncileve ekumenike të shekujve VII-VIII, por edhe nga gërmimet arkeologjike, është vërtetuar se në rajonin e quajtur Arbanon, përveç Dyrrahut, kishin mbijetuar edhe qendra të tjera urbane: Lissus-Ellισσός, Kroia - Kruja, Pulcheriopolis - Prolεσχεριουπολις, Aulona, etj. HOTI 2005.

[33] 51 HOTI 2005.

[34] HOTI - KOMATA, 2004.

[35] Repertori i artizanatit bizantin përfshin gjithashtu një numër të konsiderueshëm enësh argjendi dhe ari, si ato të gjetura në fshatin Vrap (12 km larg Tiranës). Enët e zbukuruara me motive të ndryshme u gjetën së bashku me togëza rripi të datuara në vitet 559-665: BALINT 2000.

[36] Rritja e qarkullimit të monedhave bëhet më e dukshme nga mbretërimi i Teofilit (829-842) e në vazhdim. Në katalogun e monedhave nga kjo fazë, që ruhen në Muzeun Arkeologjik të Durrësit, monedhat e Teofilit pasohen nga

Fillimi i kësaj faze shënohet nga ndërtimi i ndërtesave të mëdha fetare të krishtera.

Burimet historike tregojnë se midis viteve 813 dhe 826, në Dyrrah u ndërtua një manastir. Disa elementë arkitektonikë (kapitele, pilastra, fragmente frizash me zbukurime gjeometrike dhe bimore) të gjetura rastësisht në qytetin e Durrësit, nuk përjashtonë faktin që ato t'u përkasin rrënojave të këtij manastiri.

Pranë Kullës C të mureve bizantine, është zbuluar një bazilikë (ndoshta Bazilika e Shën Nikollës, e njohur nga burimet) me tre nefe, të ndara nga arkada, që datohet në shek. IX.

Gërmimet arkeologjike në qendër të qytetit kanë konstatuar një ndërtesë fetare shumë të madhe, ndoshta katedrale, nga e cila janë gjetur element arkitektonikë, fragmente afreskesh dhe materiale qeramike që datojnë në shek. IX-XI.

Nga fundi i shekullit të X, burimet historike përmendin gjithashtu kishën e Shën Andreas dhe "Manastirin e Detit".

Zhvillimi ekonomik i qytetit çoi në themelimin e një fortifikimi shtesë pranë "Kepit të Palit" (Porti i dytë ushtarak i Arkondisë), ku banorët ndoshta kishin mbërritur nga zonat e brendshme të rajonit, ndoshta të shtyrë nga pushtimi bullgar, i cili la disa gjurmë në disa emra vendesh (Carina, Gërdec, etj.)[37] Gjatë kësaj periudhe ishin në qarkullim në tregun e Dyrrahut: prodhime të qeramikës [38] dhe zbukurimet bizantine: unaza, gjerdanë, byzylykë, vathë, mjete liturgjike, etj. [39] Pas theme-

ato të Vasilit I (5 copë), Leonit VI (30 copë), Romanit I (3 copë), Konstandinit VII, Nikiforit II (3 copë), Fokës (3 copë), Gjon I Tzimiskes (11 copë), Basilit II (12 copë): HOTI - MYRTO 1991

[37] KEDRENUS, 550.

[38] Qeramika e gjetur në Dyrrah, Kroia, Lissos dhe Pulcheriopolis përfaqësohet nga enë të prodhimeve të ndryshme: midis tipeve të reja, janë veçanërisht amforat të tipit Otranto me dy variante: HOTI 1999.

[39] HOTI 1995.

limit të Themës[40] riorganizimi politik, administrativ dhe kishtar përshpejtoi rrethanat për transformimin përfundimtar të Dyrrahut në një qytet bizantino-arbëror, ndër më të rëndësishmit në pjesën perëndimore të perandorisë.

Ndër kohë, kronikat bizantine do përmendin qytetin dhe feudalët e tij të fuqishëm, të cilët vinin nga familjet më të njohura arbërore. Emri Albeinje shfaqet për herë të parë në këtë territor, në Bishti i Pallës.[41] Formimi i shtresës feudale të qytetit, i lidhur ngushtë me traditat vendase, ndikoi drejtpërsëdrejti me procesin e formimit të kulturës arbërore.

Dyrrahu ishte qendra kryesore për formimin jo vetëm të unitetit ekonomik dhe shoqëror, por edhe kulturor dhe gjuhësor të rajonit të Arbanonit. Lëvizjet e para antibizantine, të udhëhequra nga Peter Dailan (1041-1042) dhe George Maniakes (1042-1043), të zhvilluar në qytet, u mbështetën nga shu-mica e banorëve të rajonit të Arbanonit.[42]

Faza e pestë (fundi i shek. XI - fillimi i shek. XIII).

Pas betejës midis normanëve të Robert Guiscard dhe ushtrisë bizantine të perandorit Alexius I Komnenos në vitin 1081[43], qyteti përjetoi një periudhë të re zhvillimi, aq sa gjeografi arab Abu Abdullah Al'Idriz, e përcaktoi atë si "... një qytet i madh me shumë banorë".

Zhvillimi tregtar dhe rritja e prodhimit u shoqërua me një shtim të qarkullimit të monedhave bizantine[44].

---

[40] CONSTANTINI VII PORPHYROGENITI, De Thematibus Occidentis, sive Europae- liber II, in Imperium Orientale sive Antiquitates Constantinopolitanae, Tomus primus, Venetiis, Ex Typographia B. Javarina 1729, 21.
[41] LUKA 1969.
[42] Historia 2002, 220-221.
[43] ANNA COMNENA, Alexias, I,14; III,12; IV,1-2,6-7; V,1; VI,7.
[44] HOTI 2003 a, 48.

Në këto vite, dy lagje janë të evindetuara pranë bregdetit të qytetit: njëra e quajtur lagje venedikasve dhe tjetra e amalfitane.

Banorët italikë kishin gjithashtu kishat e tyre: Sant'Andrea u përkiste venedikasve dhe Santa Maria amalfitanëve[45].

Tregtia e Durrësit, dhe qendrave të tjera bregdetare (Shufadaja, Pirgu, Spiranica), me qytetet në anën tjetër të Adriatikut menaxhohej, veçanërisht nga venedikasit, të cilët transportonin produkte të importuara nga atje, nëpërmjet Via Egnatia, në Selanik dhe Kostandinopojë. Duke i shkëmbyer ato me mallra ekzotike, më pas, tregtarët italikë i dërgonin në Venedik dhe prej andej në Evropë.

Gjatë kësaj faze, falë këtyre kontakteve, elementë të kulturës arkitekturore romane e perëndimore u futën në Durrës dhe qendrat e tjera bregdetare të Arbërisë. Ky proces ishte veçanërisht i dukshëm pas pushtimit të Durrësit nga normanët, në vitin 1081.

Faza e gjashtë (fillimi i shek. XIII - fundi i shek. XIV). Në fillim të kësaj faze, Durrësi u organizua si Dukat Venecian. Kur Republika e San Marcos ishte nën sundimin e Dukës Peter Xian, Dukati i Durrësit qeverisej nga Manfredi i Venedikut (1210-1213)[46].

Megjithatë, në vitin 1213, despoti i Artës, Mihal I Engjëlli (Michael I Angeli), arriti ta merrte qytetin nga venedikasit[47]. Me mbërritjen e vëllait të tij, Theodhorit, në vitin 1216, qyteti mbeti

[45] Në fillim të shek.XI, juridiksioni i peshkopatit të Durrësit shtrihej nga Tivari në Vlorë. Por pas vitit 1022, selitë peshkopale të Diokleas, Ulqinit dhe Tivarit u shkëputën nga kjo peshkopatë dhe u ribashkuan me peshkopatën kryesore katolike të Raguzës. Në vitin 1054, peshkopatat e Diokleas, Tivarit, Ulqinit, Shkodrës, Pultit dhe Drishtit njohën përfundimisht autoritetin kishtar të Romës. Historia 2002, 225, 248, 263.

[46] Acta I, 129-130.

[47] Acta I, 140. ACROPOLITES, XIV,10.

nën kontrollin e Despotatit të Artës deri në vitin 1253, Ndërkohë ndikiminet Venedikut në jetën ekonomike të qytetit vazhduan pa ndërprerje[48].

Tre vjet më vonë, në vitin 1256, gjatë mbretërimit të Theodhor II Dukas Laskaris, (1254-58), kur Perandoria e Nikesë ishte zgjeruar në territoret ballkanike, (duke përjashtuar Selanikun), u pushtua edhe Durrësi[49].

Midis viteve 1257 dhe 1258, flota e Manfredit të Hohenstaufen, Mbretit të Siçilisë, e komanduar nga Admirali Philip Kinard, zbarkoi në bregdetin shqiptar dhe mori Durrësin, Vlorën, Speranzin dhe Beratin[50].

Gjatë kësaj periudhe të trazuar, qyteti megjithatë gëzoi njëfarë zhvillimi ekonomik: Para tërmetit të vitit 1273, në Durrës kishte rreth 25,000 banorë. Popullsia, e mbetur pas termetit katastrofal, gjeti strehë në Berat dhe në Itali[51].

Në shkurt të atij viti, u shpall bashkimi i Regnum Albaniae me Mbretërinë e Siçilisë, nën sundimin e Charles I të Anzhuinëve[52] dhe Anzhuinët e Napolit morën Durrësin. Për të forcuar

[48] Në vitin 1249, Nicholas More u emërua konsulent venecian në Durrës. Historia 2002, 269.

[49] ACROPOLITES, XLIX,38; LXVI-LXXX

[50] Acta I, 245, Manfredi vendosi një qeveri ushtarake në Durrës, duke emëruar, si kapiten të qytetit, Andrea Vranën, i cili vinte nga një familje feudale lokale e njohur. Pas vdekjes së Manfredit në Betejën e Beneventos (1266), francezi Charles i Anzhusë e detyroi ta njihte atë si mbretin e ri të Siçilisë

[51] PACHYMMERES V, 7.

[52] MONTI 1940, 50. Ndryshe nga Manfredi, një kundërshtar i Papës, Karli i Anzhu ishte një mbështetës i Papës. (Historia 2002, 240-241). Në vitin 1210, filluan të mbërrinin misionarë dominikanë dhe françeskanë. Ndërhyrja e tyre çoi në ndërtimin e disa kishave romane-gotike në Durrës dhe rrethinat e tij (Rodon, Çetë, etj.). (Historia 2002, 249). Një kronikë nga viti 1240 përmend dy manastire në Durrës, njëri i dominikanëve dhe tjetri i françeskanëve: shih LORENZO DA S. CROCE 1720, 256. Në këto vite, Francesco da Durazzo përmendet gjithashtu si autor i shkrimeve kishtare latine: SPINA 1995.

mbrojtjen e qytetit, ata ndërtuan një kullë të re në anën jugore të bregdetit, të lidhur me murin bizantin të qytetit. Në pjesën e sipërme të kalasë ndodhej një fortesë, ku ishin vendosur garnizonet e qytetit[53]. Tensionet politike të asaj periudhe u përkeqësuan edhe nga ndërlikimet fetare: Karl Topia (1350-1385), megjithëse princ i Arbërisë, i njohur si adhurues i Papës, në principatën e tij ishte gjithashtu mbrojtës i kishës dhe manastireve ortodokse.



Fig. 7. Karl Topia (pikturë nga Kostandin Shpataraku)

[53] Acta I, 319; 410.

Në vitin 1338, familja Topia u shpall "sunduese" e qytetit bregdetar, dhe disa vite më vonë (1368), Karl Topia u quajt "Zot i Durrësit" (Il Padrone di Durazzo)[54] (Fig. 7)

III. Periudha Veneciane (1392-1501)

Pas pushtimit të Korfuzit në vitin 1389 dhe, duke përfshirë më vonë edhe kështjellën e Butrintit, venecianët arritën gjithashtu të merrnin në kontroll fortesën dhe qytetin e Durrësit. Me një dekret zyrtar në prill të vitit 1392, princi arbëror Gjergj Topia ia dorëzoi qytetin Republikës së San Markos. Një vit më vonë, forcat veneciane depërtuan në Lezhë dhe më pas në Ulqin dhe Tivar, duke përfunduar kështu zotërimin e Arbërorëve të të gjithë bregdetit Adriatik[55].

Qeveritarët venecianë ishin nga anëtarë të familjeve të shquara si Contarini, Moro dhe Barbarigo, të cilët kishin blerë prona dhe bagëti jo vetëm në Durrës, por edhe në Vlorë dhe Butrint, dhe kishin filluar shfrytëzimin sistematik në bujqësi.

Në Durrës dhe Vlorë në vitin 1401, dokumentohet gjithashtu prania e komuniteteve hebraike të dedikuara për tregti dhe aktivitete financiare[56]. Për të forcuar sistemin e fortifikimit të qytetit, venecianët kryen restaurime (të njohura nga teknika e ndërtimit në blloqe guri paralelopipedë) dhe modifikime në kështjellën e Sipërme dhe të Poshtme, duke ndërtuar kulla të reja, përfshirë kullën e rrumbullakët, e njohur si "Torra", (Kulla A), me një strukturë tipike të shek. XV[57] (Fig. 8).

Në fillim të shek. XV, u planifikua të hapej një kanal në anën lindore të qytetit, si pjesë e projekteve hidraulike për të lidhur gjirin e Kepit Pali me Urën e Dajlanit. Më parë Repu-

[54] Acta I, 816.
[55] Acta II, 467.
[56] Ibidem.
[57] HOTI 2003a, 69-70.

blika kishte hapur një kanal në Butrint. Por në Durrës, projekti nuk u materializua mbasi kishte kosto të lartë[58].



Fig. 8. Kulla Veneciane, shek. XV (Foto: A. Hoti)

Për të inkurajuar tregtinë, përveç monedhave veneciane të njohura në Mesdhe, u prenë edhe monedha të reja (gazzettes) me legjendën: DALMAT ETALBAN[59].

Bashkëjetesa civile rregullohej me statute, jo vetëm në Durrës dhe Vlorë, por edhe në qytete të tjera. Por gjatë sundimit të familjes Topia (1368-1392), Statutet e Durrësit ishin zhkukur Gjashtë vjet më vonë (1398), 35 artikuj të këtyre statuteve u rigjetën dhe u ruajtën në manastirin françeskan të qytetit[60]. Në këto dokumente, përmenden si të pranishëm në Durrës, artizanë të ndryshëm: vazobërës, lëkurëpunues, këpucarë, kasapë etj. Një rëndësi të vecantë kishte prodhimi i kripës, i cili ishte monopol,

[58] Acta II, 481.
[59] HOTI 1988.
[60] Acta II, 676

i garantuar dhe i liçensuar me peshore publike dhe vula që u vinin thasëve të transportit.

Kripa dhe peshku ishin produktet që eksportoheshin në tregjet e Adriatikut, veçanërisht në Ankona, Venedik dhe Raguzë, së bashku me grurin, verën, mëndafshin, djathin, dyllin, bagëtinë. Ndër eksportet e kërkuar ishin dhe kuajt e famshëm. Importet përbëheshin nga materiale të çmuara (pëlhura, armë, bizhuteri dhe qelq), por edhe sende për përdorim të përditshëm dhe shtëpiak, që vinin nga Venediku, e Raguza[61], dhe qytete të tjera italiane. Enët e glazuruar të prodhuar në Venedik ishin shumë të vlerësuar në tregun e Durrësit[62]. (fig. 9)



Fig. 9. Portret femre në një vazo të shek. XV (pikturoi A. Dedja)

[61] Në shek.XIII, Durrësi preu monedhat e veta, që.siç dëshmohet në mënyrë indirekte nga falsifikimet e bëra në Raguzë, duhet të kenë pasur një vlerë mjaft të lartë. HOTI 2003a, 12

[62] HOTI 1989.

IV. Periudha Osmane (1501-1912)

Sipas kronikanëve europianë të shek. XVI, qyteti i Durrësit, të cilin ata e quanin në mënyrë retorike "Kostandinopoja e Dytë", u pushtua nga turqit më 15 gusht 1501[63]. Pushtimi osman pati pasoja të rënda jo vetëm Durrësin, por në të gjithë Arbërinë.

Faza e parë (1501-1831/1840). Qyteti i madh dhe madhështor u tkurr gradualisht në 100-120 shtëpi dhe mbeti i tillë për një periudhë relativisht të gjatë[64]. Menjëherë pas pushtimit, u përurua xhamia e quajtur "Fatih" (I ndrituri), për nder të Sulltan Muratit II, i cili kishte marrë qytetin. Ndërkohë ndërtohet xhamia e përshtatur mbi rrënojat e një bazilike kristiane të shek. X-XI (muret e saj ndjekin perimetrin e kishës) me një plan të thjeshtë, të ndarë në një sallë lutjesh, portik dhe minare[65].

Aty nga mesi i shek. XVII filloi të riorganizohej Kisha Katolike. Episkopata e Durrësit kishte një numër dioqezash nën juridiksionin e saj: përveç asaj të Durrësit, Krujës, Arbërisë, Lisit (Matit), Bendës (rajoni i Shën Gjergjit, Tiranë) dhe Kunavisë (komunitetet në zonën midis Durrësit, Tiranës, Peqinit dhe Kavajës)[66].

Në shekujt XVI dhe XVII, qyteti u përfshi në njësitë e reja administrative-ushtarake osmane. Në fund të shek. XVII qyteti rifilloi një rol aktiv tregtar dhe detar, duke u bërë porti kryesor për Shqipërinë qendrore, ku vepronin rreth 100 tregtarë vendas (nga Shkodra, Elbasani, Voskopja, etj.), por edhe të huaj. Këta

[63] Otomanët kishin depërtuar për herë të parë në rajonin shqiptar gjatë mbretërimit të Sulltan Muratit I (1443), por kronikani turk Oruxh thotë se, kohë më parë, që në vitin 1384, forcat ushtarake të Timur Tash Pashës kishin arritur në portat e Durrësit: DASHI 1996, 69.

[64] HOTI 2003a, 38-39.

[65] MEKSI 1986, 2, 370.

[66] Një raport nga peshkopi katolik i shek.XVII në Durrës, Gerardo Gallata, rezulton se në dioqezën e tij, kishte një rritje të pronave tokësore të kishave dhe një përqindje e konsiderueshme të këtyre pronave dispononinfusha dhe pyje: Hylli i Dritës, 291.

të fundit kishin magazinat e tyre në këtë qytet dhe rigjallëruan marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare, jo vetëm me pellgun Adriatik dhe Mesdhetar, por edhe me Evropën Qendrore.

Në shek. e XVII tregtarët venecianë dhe fiorentinë vazhduan të eksportonin mallra nga Shqipëria nëpërmjet porteve të Durrësit, Vlorës, dhe portit lumor të Lezhës. Gjatë vitit 1699, u eksportuan nga Durrësi në Venedik, 3,000 kuintalë dyll, 15,000 kuintalë lesh të cilësisë së lartë dhe një sasi e konsiderueshme lëkurash.

Të dhënat e gërmimeve tregojnë se kisha është përdorur vazhdimisht, edhe pasi dyshemeja ishte mbushur pjesërisht me mbeturina. Zbulimi i qeramikës së periudhës osmane, nën dyshemenë e Kishës A, (fig. 2 e 3) tregon se Kapela dhe strukturat e tjera përreth, kanë qenë përdorur për një kohë të gjatë, ndoshta deri në shek. XVII.

Gërmimet në Kishën B, ofruan të dhëna se, përshtatja mund t'i përkasë fundit të shek. VI. Ndërsa zbulimi i fragmenteve të

[9] Përshtatjet e bëra në kohë të ndryshme nuk mund të ndryshonin bazën e ndërtimit të monumentit. Strukturat kryesore vazhduan të ruheshin në gjendje relativisht të mirë. Një pjesë e madhe e strukturave arkitektonikë mbetën të padëmtuar, aq sa sot, është i mundur një rindërtim i fazës fillestare.
[10]Mbishkrimi është dygjuhësh (biling) kombinim i latinishtes dhe greqishtes: F. Miraj, Mbishkrime latine të Durresit, Monumentet, 1-2, 1991, f. 273. Po qe se kjo pllakë është ripërdorur, më vonë, si material në anët e altarit të kapelës, dhe vetë altari i përket fazës së parë të ndërtimit, atëherë data e ndërtimit të kapelës duhet të ketë qenë pas mesit të shek. V. Shih: S. Santoro, A. Hoti, B. Sassi, Dyrrachium I, Amfiteatri i Durresit. Studime dhe Gërmime 2004-2005, Annali Scuola Archeologica Italiana Atene LXXXIII, s. III, 4, T. II, 2006, p. 725). Edhe studiuesi V. Toçi mendon të njëjtën gjë kur thekson se faza e parë e varrimëve datohet në një kohë, para ndërtimit të Kapelës: V. Toçi, vep. cit. shënimi 1, Tab. I, fig. 2.
[11] S. Santoro, A. Hoti, B. Sassi, Dyrrachium I…, vep. cit. shënimi 9, f. 725.

afreskeve në muret e interierit të saj, datuar në shek. XII-XIII, tregojnë se kisha është dekoruar në një fazë të mëvonshme[12].



Fig. 1 – Pjesë e amfiteatrit të Durrësit dhe Kishës A, mesi i shek. V pas Kr. (zbuluar në vitet 1966-1970 nga Vangjel Toçi)
(Foto A.Kavaja)

Përveç ndërtimit dhe përdorimit të objekteve kultit, të dhënat e fundit të gërmimeve, tregojnë gjithashtu edhe ndërtimin e një banese brenda zonës së amfiteatrit, një ndërtesë që daton jo më herët se fillimi i shekullit të VI[13].

[12] K. Boës, A. Hoti, vep. cit. shënimi 1, f. 392-393.
[13] S. Santoro, A. Hoti, B. Sassi, The Roman amphitheatre of Durazzo (Albania). Raporti i gërmimit 2006-2007, ASAtene LXXXVII, seria III, 9, Vëllimi II, 2009, f. 1260-1262.

Rinovimet më të fundit të kësaj ngrehine datojne në mesin e shek. XVII, kur, në skajin jugperëndimor të perimetrit të katit të parë të amfiteatrit, u bënë modifikime për të akomoduar një njësi të ushtrisë osmane[14].

Krahas përshtatjeve, amfiteatri pësoi një sërë shkatërrimesh. Fillimisht, pothuajse të gjitha pllakat e veshjes së shkallares u hoqën, dhe më vonë, në disa nga fragmentet e strukturave u shkatarruan masa jo të vogla betoni.



Fig. 2-3-Dyshemeja e Kishës A (Foto 1989, nga A. Hoti)

Varret. Gjatë gërmimëve në amfiteatër, u zbuluan 85 varre, të fiksuara brenda arenës ose në afërsi të saj, pranë kishave dhe përgjatë galerive[15].

Varret nga faza e parë (shekujt V-VII), për sa i përket mënyrës së ndërtimit, i përmbahen traditës së varrimit provincial romak, madje duke ripërdorur tulla dhe tjegulla të shekujve të parë të erës sonë.

Tipi më karakteristik i këtyre varreve është ai i ndërtuar direkt mbi tokë, i mbuluar me tjegulla në formë çatie me dy kreshta.

[14] L. Rey 1925, vep. cit. shënimi 3, fig 18.
[15] V. Toçi, vep. cit. shënimi 1, f. 39-40.

Një tip tjetër është ai me varre të thjeshta (gropë dheu), një ritual që ndeshet edhe në varreza të tjera të mesjetës së herëshme në qytetin e Durrësit.

Në këtë nekropol të krishterë, varrimi bëhej duke e vendosur trupin direkt në dyshemenë e varrit, me skelet të shtrirë, krahë të kryqëzuar (në gjoks ose në bark) dhe këmbë të shtrira.

Shumica e varreve përmbanin vetëm një skelet; vetëm një numër i vogël i tyre, përmbante dy skelete. Në përgjithësi, varreve u mungonte inventari; tek disa prej tyre, kishte një numër të kufizuar objektesh.

Varret e fazës së dytë (shek. VIII-XI/XII), sipas të dhënave të gërmimëve, zënë pjesën më të madhe të varrimëve. Në inventarin e ndonjerit prej tyre, u gjetën tokëza të tipit korintik (shekujt VII-VIII) [16].

Gjetjet arkeologjike. Në kontekste dhe shtresa kulturore u mbodhën objekte të kategorive të ndryshme: objekte qeramike, qelq, vegla pune, monedha dhe stoli bizantine. [17]

Repertori i enëve të tryezës, në aspektin morfologjik, përfaqësohet nga një sërë formash. Gjetjet përbëhen kryesisht nga fragmente brokash, kotruve dhe vorba, ndërsa në një numër më të vogël, janë amforat, oinohetë dhe enë të tjera, që datohen në harkun kohor të shek. VI-VIII.

Midis enëve të transportit, ka edhe amfora nga Puglia, të njohura si tipe "Otranto". Këto enë, që qarkullonin në portet

[16] L. Miraj, Adaptime në amfiteatër gjatë shek. VI-XII, Monumentet, 1991/1-2, f. 56, fig. 16, 2.

[17] Materialet arkeologjike: Qeramika, qelqi, punimet artizanale, monedhat dhe materiale të tjera të gjetura në këto gërmime janë botuar: A. Hoti, *Enë më glazurë nga qyteti i Durrësit (shek. X-XV),* Iliria, 1, 1989, f. 213-230; A. Hoti, H. Myrto, *Monedha perandorake bizantine nga Durrësi*, Iliria, 1991, 1-2, f. 91-122; P. Papadopoulou, *Tétartèra d'imitation du XIIIe siècle: à propos du tresor de Durrës (Albanie),* RN, 6e serie, 161, 2005, f. 145-162.

Adriatiko-Joniane, midis shek. IX dhe XI-XII, ishin ndër objektet më të zakonshme në tregun e qytetit të Durrësit[18].

Qeramika e glazuruar u evidentua në kontekste të shtresave të sipërme të Mesjetës së Hershme, veçanërisht në njësitë stratigrafike të shtresave kulturore të mesjetës së mesme, ku, monedhat bizantine, të shoqëruara me to, herëherë, kanë shërbyer për datimin e tyre.

Enët e glazuruara përbëhen nga broke, kupa e pjata dhe, në një masë më të vogël, tasa, tenxherë dhe kana[19].

Ndër gjetjet më të hershme, spikasin enët bizantine të zbukuruara me teknikën zgraffito. Ndër këto, dallohen enët me lustër të bardhë monokrome, të zbukuruara me teknikën "spirale", që datojnë në gjysmën e parë të shekXII[20].

Midis enëve me glazurë, ndeshet edhe qeramika protomajolike, e përfaqësuar nga disa fragmente enësh tavoline të tipit Brindiziot, të gjetura në kontekste të mesit të shek. XIII, shoqëruar me monedha të perandorëve latinë. Enët protomajolike ishin ndër mallrat luksoze, më të kërkuara në tregun e Durrësit[21]

Produktet e artizanatit përfaqësohen nga një numër i kufizuar gjetjesh prej hekuri: thika, togëza, gjilpëra, etj. Objektet

[18] A. Hoti, Some features of the early medieval pottery in Albania (7-11 centuries), VIIe Congres International sur la Céramique Médiévale en Méditerranée, (Thessaloniki 11-16 Octobre 1999), Athènes, 2003, p. 237-240.

[19] Nga amfiteatri vijnë enët me glazurë, pa dekor: A. Hoti, Enë më glazurë, vep. cit. shënimi 16, f. 215, Tab. I, 18; fq. 216, nr. 10, 17; enë me zbukurime sgrafito, f. 218-219, tab. III, 3, 7, 8, 13, 17, 19; f. 219, tab. IV, 1-2, 5, 7-8, 10, 12; f. 222, tab. X, 3; enë me zbukurime polikrome, f. 226-227, tabela X, 7-8, 11, 17-18, 20

[20] A. Hoti, Enë më glazurë vep. cit. shënimi 16, f. 217-218.

[21] A. HOTI, Enë më glazurë vep. cit. shënimi 16, f. 223-227.

prej argjendi përbëhen nga: unaza, vathë, varëse dhe enkolpione të tipit "Holy Land"[22] (Fig. 4).

Gjatë gërmimeve arkeologjike në amfiteatër janë gjetur edhe një koleksion me monedha perandorake bizantine prej bronzi. Disa prej tyre datojnë nga mbretërimi i Justinit II (565-566) deri në fund të mbretërimit të Vasilit I (1025) [23]. Me përjashtim të një monedhe prej ari (Konstandini IV Pogonatis, 668-683), e gjthë pjesa tjetër përbëhet nga monedha prej bronzi.

Gjetja i një thesari prej 912 monedhash të bronxtë, nën strukturën e altari të Kapelës, datuar në fillim të shek. XIII, përfaqëson një zbulim të rëndësishme, që hedh dritë mbi qarkullimin monetar dhe aktivitetin tregtar të qytetit të Durrësit[24]

[22]Pjesa e përparme e kryqit përshkruan imazhin e Krishtit, ndërsa pjesa e pasme përfaqëson Hyjlindësen (Theotokos), dëshmitaren e jetës dhe vdekjes së tij: Duke pasur parasysh rrethanat kontekstuale të zbulimit të tij, enkolpioni është datuar midis shek. IX-XI. Këto kryqe janë konsideruar objekte me vlerë të përftuar nëpërmjet lidhjeve të drejtpërdrejta me Tokën e Shenjtë (nëpërmjet pelegrinëve) ose të siguruara nëpërmjet marrëdhënieve tregtare me qytetin e Kostandinopojës me zonat përreth saj: A. HOTI, Croix-pendentifs mesjetare të gjetura në Albanie, Studia Albanica, 1995-1999, Tiranë, 2000, f. 32, I, 1-2, fig. 3

[23] Kronologjikisht, gjetjet numizmatike ndjekin këtë klasifikim: Perandori Justin II (prerje e viteve 565-566?); Konstandini IV Pogonati (prerje e viteve 668-683); Teofili (prerje e viteve 830-842); të tre përfaqësohen me nga një monedhë secili. Më pas vijnë monedhat e Bazilit I (prerje e viteve 867-886 – 1 copë); Leoni VI (prerje e viteve 886-912 – 3 copë); Romani I (prerje e viteve 919-921 – 3 copë); Nikifori II Foka (prerje e viteve 963-969 – 1 copë); Gjon I Tzimisku, (monedhë e viteve, 969-976 – 3 copë); Bazilika II (monedhë e viteve, 976-1025 – 5 copë): shih, A. Hoti, H. Myrto, Monedha Bizantine Perandorake nga Durrësi, Iliria, 1991, 1-2, f. 91-122.

[24] Thesari i gjetur në altarin e Kapelës përbëhet nga imitime, tetartera nga fillimi i shek. XIII, ndoshta monedha të prodhuara nga venedikasit në Korint. P. Papadopoulou, Tétartèra d'imitation, vep. cit., shënimi 16, f. 158



Fig. 4 – Kryq relikti (enkolpion bronzi), shek. X-XI. (Foto A.Hoti)

Kultura bizantine e zbuluar në amfiteatrin e Dyrrahut është një nga dëshmitë e fillimit të përshtatjeve dhe evolucionit të kultit të krishterë në këtë pjesë të qytetit.

Pasi pushoi së funksionuari, transformimi i amfiteatrit, nga një arenë për spektakle publike, në një qendër të adhurimit të krishterë, nuk ndodhi menjëherë, por gradualisht, përmes disa fazave. Secila prej këtyre fazave karakterizohet nga një sërë ndryshimesh që shprehin evolucionin e kultit kristian nga shekujt e parë pas Kr. deri në mesjetën e vonë.

Bazuar në të dhënat e mbledhura deri më tani, kisha A, u përshtat në strukturat e braktisura të amfiteatrit, aty nga fundi i shek. V pas kr[25].

Arena dhe galeritë e amfiteatrit vazhduan të ishin parcela varrimi të përdorëshme gjatë gjithë antikitetit të vonë deri në mesjetën e vonë.

Prania e një banese në jug të monumentit, e zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike italo-shqiptare[26], tregon se vetëm një pjesë e kufizuar e amfiteatrit është përdorur si zonë banimi.

Nga gërmimet e kryera deri më tani, ende nuk mund të konkludojmë se, kjo pjesë e qytetit bizantin, ishte një njësi të veçantë banimi. Andaj zona e amfiteatrit, nuk mund të konsiderohet një hallkë e rëndësishme urbane, por thjesht një territor i braktisur, përshtatur si qendër varrimi.

Si pjesë e riorganizimit të qytetit paleobizantin, zona e amfiteatrit, së bashku me dy kishat, zinte një hapësirë urbane midis ndërtimëve të reja të zonës përrreth.

Duke qenë, pranë Macellumit, zona e amfiteatrit, përfaqësonte një zonë të kulti kristian. Krahasuar me pjesën tjetër të qytetit, investimet në zonën e amfiteatrit, gjatë periudhës paleokristiane ishin të kufizuara. Me sa duket, shumica e fondeve u përdor për ndërtimin e Macellumit dhe grupit peshkopal në veri të tij[27].

---

[25] Krishtianizimi i amfiteatrit është një nga dëshmitë e drejtpërdrejta që kemi për proceset e reja të transformimit të Durrësit, nga një qytet provincial romak në një qytet tipik të krishterë bizantin. A. Hoti, Des données archéologiques sur le christianisme ancien à Dyrrachium, IVe-VIIe siècles, Iliria, 1996, 1-2, f. 173-181.

[26] S. Santoro, A. Hoti, B. Sassi, The Roman amphitheatre…, op. cit., shënimi 12, f. 1260-1262.

[27] A. Hoti, Des données, vep. cit., shënimi 24, f. 173-181.

Rreth mesit të shekullit të VII, pas braktisjes së Maçellumit, edhe ky monument humbi funksionin e tij dhe u shndërrua në varrezë.

Rrënimi e qendrës së qytetit dhe shndërrimi i saj në një vend varrimi është një dukuri që ndodhi edhe në qytetet bizantine të Azisë së Vogël dhe Ballkanit[28].

Gjatë shekujve VII-VIII, u vu re edhe një lloj varfërie në jetën të përditshme, një dukuri, që konstatohet, jo vetëm në inventarin e varreve, por edhe nga shtresat kulturore të depozituara midis rrënojave të amfiteatrit dhe monumente të tjerë të zbuluara në Durrës.

Kjo periudhë krize u shoqërua edhe me një rënie të ndjeshme të qarkullimit monetar, çka solli si pasojë një dobësim të dukshëm të varësisë ekonomike dhe politike nga Bizanti.

Nga studimi i dokumenteve arkivore dhe historike të fundi i shek. të XVI e në vijim, si dhe nga të dhënat arkeologjike, del se kishat dhe varrezat e në amfiteatrit, u braktisën dhe, pas më shumë se dy shekujsh, e gjithë zona dhe shkallaret, u mbuluan, ndërkohë që, banesa të reja mesjetare, u ndërtuan mbi këto depozitime.

[28] A. Hoti, L'Illirico sud-occidentale nei secoli IV-VII, *Gli Illiri e l'Italia, Atti del Convegno Internazionale di Studi*, (Treviso 16 ottobre 2004*),* Treviso 2005, p. 53-75.

Dati sulla cultura materiale bizantina dell'anfiteatro di Durazzo

(scavi degli anni 1966-2002)

(Astratto)

Durante il lungo quanto discontinuo period di attività di scavo nell'anfiteatro di Durazzo (1966-2000), sono stati messi in luce numerosi resti ed elementi strutturali appartenenti al monumento.

Tra essi si segnalano le parti fondamentali della scalinata e all'incirca un terzo delle gallerie della parteoccidentale.

Interesse particolare ebbe anche la scoperta delle due chiese, in una delle quail si conserva un pregevole mosaico parietale.

Inoltre, sia nell'arena che anche all'interno delle gallerie interratesi ormai da secoli sono state rinvenute numerose sepolture altomedievali nonché stratificazioni contenenti materiali di varia altre tipologie (fig. 1).

La storia degli scavi. La riscoperta delle strutture dell' anfiteatro ebbe inizio nel maggio dell'anno 1966, quando l'archeologo V. Toçi, a seguito di una analisi urbanistica dell'area centrale di Durazzo si rese conto dell'esistenza del calco urbano dell' anfiteatro menzionato dalle fonti e diede inizio gli scavi archeologici di verifica.

Gli ulteriori scavi (1983-2000), si concentrarono nella parte occidentale delle gallerie e parzialmente nell'arena, e portarono alla scoperta, oltre che di altri reperti e sepolture, anche della seconda chiesa Cristiana.

Adattamenti nelle strutture dell'anfiteatro I primi decenni del V secolo possono considerarsi

l'epoca di collocazione del primo gruppo di sepolture, mentre contemporanea o di poco successiva sarebbe l'adattamento delle strutture dell'anfiteatro a cappella funeraria (chiesa A) (fig. 2 e 3), la quale viene appunto datata alla fine del V secolo insieme ad un secondo gruppo di sepolture

Gli scavi nella chiesa B, collocata di fronte alla chiesa A, ci dimostrano che la sua costruzione può collocarsi verso la fine del sec. VI secolo. La scoperta degli frammenti dell' affresco nel suo interno, che invece si data al XII-XIII secolo, testimonia anche che in una seconda fase questa cappella sia stata abbellita.

Le strutture dell'anfiteatro dopo il loro adattamento a nuovi usi vennero adibite oltre che a funzioni sepolcrali e cultuali anche ad area abitativa, come testimoniato dal rinvenimento dei resti di almeno una probabile abitazione, la cui costruzione si data a non prima del VI secolo.

L'ultimo episodio degli adattamenti di riutilizzo dell' anfiteatro ebbe luogo verso la fine del XVII secolo, quando all'estremità sud-occidentale del primo piano dell'anfiteatro, vennero effettuati lavori për la realizzazione di postazioni dell'esercito turco.

Tombe. Durante gli scavi nell'anfiteatro si sono scoperte un totale di 85 tombe, alcune delle quali collocate dentro lo spazio dell'arena oppure alla sua periferia, mentre altre si trovavano vicino alle chiese e lungo gli spazi delle gallerieLe tombe della prima fase (sec. V-VII) si distinguono in quanto si attengono alla radizione romana, facendo addirittura uso di mattoni e tegole di riuso prodotti del I sec.

Le tombe della seconda fase (sec. XI/XIIXIII), sono quelle più numerose ed occupano la parte maggiore del cimitero dell'anfiteatro.

Reperti archeologici. I materiali rinvenuti nel corso del tempo e provenienti dai diversi strati sono numerosi ed ascrivibili a differenti categorie: manufatti qeramici, utensili, oggetti di vetro, monete e gioielli.

I prodotti di artigianato sono rappresentati da un numero limitato di reperti di ferro: coltelli, fibbie, aghi ect. Ma sono presenti anche anelli, orecchini, pendenti, enkolpions del tipo "Holy Land" (fig. 4).

Infine, come abbiamo visto essere testimoniato sia dalle fonti letterarie dell'inizio del XVII secolo che anche dall'esito degli scavi di lì ad un paio di secoli le strutture dell'anfiteatro persero anche questa funzione për poi interrarsi almeno parzialmente insieme all'arena, ed essere infine occupate da numerose abitazioni medievali.

IV

NOTIZIE PRELIMINARI SUL RINVENIMENTO DI UN DEPOSITO DI GROSSI RAGUSEI NELL'ANFITEATRO DI DURAZZO

Il rinvenimento

Nel corso della campagna di scavo 2006, è stato rinvenuto un deposito monetale costituito da 549 monete ragusee, coniate fra la seconda metà del XVI secolo e il 1621.

Il rinvenimento (Reperto 52) è avvenuto nell'ambiente A-C del palatium medievale, costruito nel corso del XII secolo sui resti crollati della parte meridionale della cavea dell'anfiteatro ed abitato, con numerosi rifacimenti, fino ad una trentina di anni fa (Fig. 14). Le monete erano contenute in una brocchetta in ceramica invetriata dipinta di XVI secolo (Fig. 13, 2 e Fig. 15), collocata immediatamente al di sotto di un battuto pavimentale US 180, ossia nel sottofondo US 261, databile in base all'analisi dei materiali diagnostici al XVI-XVII secolo.

Le monete si presentavano fortemente ossidate e costituivano una massa aggregata che, ad un esame radiografico, appariva costituita da due parti, intervallate da un sottile spazio vuoto, forse perché il deposito era avvenuto in due tempi o perché fra le due parti era un elemento organico, forse un sacchetto di tela. Infatti, sottoposte al restauro da F. Stamati, 53 esemplari sono risultati forati e quindi potevano essere stati riposti separatamente dagli altri.



Fig. 14 - Il contesto di ritrovamento: l'ambiente A-C, nel sottofondo pavimentale US 261.
(Archivio "Progetto Durrës 2003 - 2015")



Fig. 15 - La brocchetta in situ con le monete in essa riposte, al momento del ritrovamento.
(Archivio "Progetto Durrës, 2003 - 2015")

Il deposito è costituito da 549 monete d'argento della zecca di Ragusa (odierna Dubrovnik). Si tratta di un'unica tipologia monetale indicata nei testi di numismatica con il nome di "grosso" (o dinar). Salvo un unico esemplare più antico, la restante parte del deposito copre un arco cronologico che va dalla seconda metà del XVI secolo al 1621. In quell'anno fu mutata leggermente la tipologia del grosso e fu introdotto sulle nuove emissioni l'uso di riportare il millesimo di coniazione. Questo cambiamento fu accompagnato da un abbassamento della lega e del peso. A partire da questo momento è, oggi, consuetudine definire il medesimo nominale con il nome di "grossetto" (dinarić).

Il grosso raguseo iniziò ad essere coniato a Ragusa nel 1337. Il suo valore era di 30 folar (o minça) di rame. Inizialmente aveva un peso di 1, 8 g, un diametro di 19-20 mm con un fino di argento di 916 ‰. Tuttavia, verso il primo ventennio del '600, riduzioni progressive në avevano ormai portato il peso a 0, 55 g circa, il diametro a 17, 5 mm circa, mentre il fino era stato abbassato a 800 ‰. Nei secoli XIV-XVI, il grosso di Ragusa circolava con un valore pari ai 2/3 del grosso veneziano, quest'ultimo ampiamente presente nella vasta area degli interessi economici della Repubblica veneta e quindi anche nell'area dalmata ed illirica.

La tipologia 'base' del grosso, mantenutasi sostanzialmente stabile për oltre tre secoli, è la seguente:

- D/ (da ds., in alto) S BLASIVS RAGVSII. San Biagio aureolato, stante di fronte, con mitra e in abito vescovile, benedicente con la mano destra e con il pastorale nella sinistra.

- R/ anepigrafe. Nel campo, il Redentore nimbato, in mandorla, benedicente con la mano destra. Tiene il Libro nella sua sinistra. Ai lati della mandorla, in posizione orizzontale, gruppi monogrammatici për Iesus Xristus (variamente espressi nelle diverse emissioni: p. es. IC-XC, oppure IE-XE, ecc.) con sovrastante segno di abbreviazione paleografica.

In conformità con la politica monetaria di Venezia, con la quale Ragusa intrattenne attivi rapporti e non solo di natura commerciale, le raffigurazioni si mantennero fisse për molto tempo, con variazioni pressoché minime nella figura di San Biagio e del suo talare, così come dell'immagine di Cristo. Una parte dei primi grossi riporta alla destra del santo un segno distintivo di emissione o dello zecchiere, mentre a partire dal 1452 si stabilizza la presenza in una 'R'. Al rovescio, invece, nell'ultima emissione del 1617[1], il Cristo tiene nella sinistra al posto del Libro un globo, mentre il segno di abbreviazione sopra i monogrammi, prima lineare, prende ora la forma di un omega. Particolari secondari hanno consentito di distinguere fra loro diverse emissioni di grossi, prodotti fra la prima metà del Trecento e il 1621: questi particolari saranno illustrati soltanto për i tipi effettivamente presenti nel ritrovamento. La classificazione e la cronologia adottate si basano sul testo di Božan Mimica[2], il quale, fra i recenti studi sulla monetazione di Ragusa, risulta il più pratico e aggiornato, riprendendo sostanzialmente la suddivisione dei grossi in 47 differenti tipi già adottata dal Režetar[3].

Per completezza sono state verificate le concordanze tra la cronologia proposta da Mimica e i tipi e le datazioni utilizzate nel *Corpus Nummorum Italicorum*[4], a sua volta basato sulla pubblicazione di Milan Režetar[5], nonché della pubblicazione di Bernhard Prokisch et al.[6], quest'ultima peraltro estremamente sintetica (v. infra, Tab. 1).

Le 549 monete componenti il ritrovamento sono così distribuite secondo i tipi del Mimica:

[1] MIMICA 1994, per il tipo 47.
[2] MIMICA 1994.
[3] REžETAR 1924-25.
[4] CNI 6.
[5] REžETAR 1905.
[6] PROKISCH et alii 1999.

MIMICA 1994	PROKISCH 2000	REžETAR 1905	CNI 1922
38 (?)			
41 (1539-1556)	10/01 (1449-1471)	6º (1450-1580)	VI fino al 1571
42 (1558-1571)	10/02 (1558-1571)	“	“
43 (1581-1594)	10/03 (1581-1594)	7º dal 1580	VII dal 1580
44 (1581-1594)	10/03 (1581-1594)	“	“
45 (1591)	-	9º fine XVI secolo	IX fine XVI sec.
46 (1594-1613)	10/04 (1594-1613)	8º fine XVI secolo	VIII (1594-1613)
47 (1617-1621)	10/05 (1594-1613)	10º inizio XVII	X (1617-1621)

Tab. 1 - Comparazione delle classificazioni dei grossi ragusei

Tipo 38 (?): 1 pezzo; 0,71 g (Fig. 16). Questa moneta è l’unica del ritrovamento a non avere una ‘R’ a sinistra di San Biagio come segno distintivo. A causa dell’usura dell’esemplare, il simbolo osservato non è facilmente riconducibile ad un segno noto e riportato nei repertori citati. L’attribuzione al tipo 38 del Mimica è pertanto da ritenere solo dubitativa: se l’attribuzione fosse corretta, l’emissione sarebbe datata a partire dal 1438.

Tipo 41 (1539-56): 1 pezzo, forato. 0,63 g (Fig. 17). D/ San Biagio in talare greco; R/ ai lati del Cristo: I -X.

Tipo 44 (1581-94): 2 pezzi, forati; 0,62 e 0,63 g (Fig. 18). D/ San Biagio in talare greco, sul quale è stata apposta una contromarca con immagine stilizzata di città[7]; R/ ai lati del

[7] Si tratta dell’immagine stilizzata della città di Ragusa, raffigurata nella mano del suo protettore. A questo proposito, si deve segnalare che gli autori citati propongono, per l’apposizione delle contromarche sui tipi 43 e 44 (v.

Cristo: IC (o IX) -XI (o CI, o IC, o XC). Una contromarca con testa vescovile (San Biagio) è apposta sulla figura di Cristo.

Tipo 45 (1591): 1 pezzo, forato e mancante di frammenti (Fig. 19). D/ San Biagio in talare romano; R/ Cristo con libro senza punti. Ai lati: IE-XE.

Tipo 46 (1594-1613): 27 pezzi, 11 dei quali forati (Fig. 20). D/ San Biagio in talare greco sul quale è l'immagine stilizzata della città, non come contromarca, ma incisa nel conio; R/testa vescovile di San Biagio impressa sul petto di Cristo: non è una contromarca ma è di conio. Ai lati di Cristo: I -X.

Tipo 47 (1617-21): 515 pezzi, 38 dei quali forati (Fig. 21). D/ San Biagio in talare romano con grande croce, tiene nella sinistra l'immagine della città; R/ Cristo tiene nella sinistra il globo; ai lati: I -XP. I segni di abbreviazione paleografica sono a forma di omega.



Fig. 16 - Il Grosso di tipo 38 ?



Fig. 17 - Grosso di tipo 41



Fig. 18 - Grosso di tipo 44



Fig. 19 - Grosso di tipo 45

Tab. 1), una data intermedia (1580-84) fra quella della loro coniazione come tipi 41 e 42 (1539-1571) e la data del tipo 46 (1594-1613) che riporta le stesse immagini, direttamente impresse nei conii. Credo che si possa con ragione ipotizzare che l'apposizione delle contromarche sui vecchi pezzi tipo 41 e 42 non sia avvenuta nel periodo intermedio 1580-1594 ma sia stata effettuata dopo l'adozione del tipo 46 (dal 1594), per adeguare queste monete, ancora circolanti, alla nuova emissione e per renderle, in tal modo, egualmente accettabili sul mercato.



Fig. 20 - Grosso di tipo 46



Fig. 21 - Grosso di tipo 47

Sono infine presenti 2 frammenti non classificabili.

Ventiquattro monete si presentano mancanti di qualche frammento. Alcune, spezzate in due o più parti, sono state restaurate dopo la pulitura. Diversi esemplari mostrano segni di corrosioni superficiali che in otto esemplari divengono piccoli fori accidentali. In quattro pezzi si notano alcune superficiali mancanze di metallo da erosione (significa che derivano o da difetti del tondello prima della coniazione o più verosimilmente da erosioni verificatesi durante i secoli di deposito e evidenziate dalla successiva pulitura che ha eliminato le aree erose e pertanto intaccate dalla ossidazione).

Sulle monete più antiche (tipi 38, 41, 44) si evidenzia un discreto stato di usura da circolazione, mentre numerosi pezzi dell'ultima emissione (tipo 47) sono in buona o in ottima conservazione, con scarse tracce di usura.

L'orientamento dei conii appare essere del tutto casuale. Il peso degli esemplari dei gruppi 46 e 47 varia da 0,49 g a 0,54 g. Il diametro delle monete varia da 16,5 a 18 mm.

L'esame diretto dei pezzi conferma l'adozione, per l'ultima emissione definita con il tipo 47, di una diversa tecnica di produzione dei grossi. In esemplari lievemente decentrati e con tondello largo, si può infatti osservare una lieve "scodellatura" periferica della moneta che dimostra l'utilizzo della tecnica di coniazione mediante rulli contrapposti e successiva fustellatura dei pezzi. La scodellatura concava del bordo periferico è prevalentemente osservabile dal lato con San Biagio, ma è pre-

sente, sia pure in un numero limitato di pezzi, anche dall'altro lato che presenta l'immagine del Cristo.

I pezzi forati - che costituiscono la quasi totalità delle tipologie più antiche - costituiscono il 40% circa del tipo 46, mentre una parte, seppur limitata (7,5%), dell'ultima emissione appare forata.

I fori sulle monete presentano sezioni differenti e sembrano essere effettuati con diversi strumenti: chiodo o punteruolo a sezione rotondeggiante, quadrata o triangolare oppure un colpo di tagliente o di cesoia. Questo aspetto del problema potrebbe significare che la perforazione dei pezzi è stata effettuata non solo in modi, ma anche in momenti o tempi diversi. In due casi sono presenti due fori sulla stessa moneta.

Va ricordato che, all'esame radiografico del conglomerato (Fig. 22), la presenza di un intervallo fra due parti del deposito, può indicare due depositi successivi oppure che almeno una di esse poteva essere avvolta da un elemento organico.




Fig. 22 - Radiografia del conglomerato monetale prima del restauro. L'intervallo visibile fra due parti del deposito potrebbe indicare la presenza di un elemento organico che forse avvolgeva, separandoli, due gruppi di monete

Il ritrovamento: alcune ipotesi interpretative

Sul piano storico, si deve ricordare che nei secoli XVI e XVII la città di Durazzo fu inclusa nelle unità amministrativo-militari turche. në L'Ottomanno di L. Soranzo pubblicato a Ferrara nel 1598[8] si legge: "Durazzo non ha porto për quattro galere e nell'entrata le secche sono molto pericolose". Similmente, dalla relazione di viaggio Itinerarium Hierosolimitanum di J. Kotovich[9], apprendiamo che Durazzo "hodie exiguum, semidirutum et parvum frequentem refert locum". J. Spon e G. Wheler ricordano la città "qui étais le Dyrrachium des Romains" ed oggi "n'est qu'un village avec une forteresse ruinée"[10]. Poco più tardi (1686), però, dal Governo raguseo parte un'istanza riservata alla Sublime Porta, affinché si deliberi la "serrata dello scalo di Durazzo" perché "all'hora necessariamente concorrerebbero tutte le merci a questo scalo [di Ragusa]"[11]. Pochi mesi dopo, il Senato Raguseo chiede al proprio rappresentante presso il Pascià di Bosnia di provvedere alla stessa operazione di chiusura del porto di Durazzo[12]. Nel 1699, è attivo a Durazzo un console francese che magnifica al proprio Ministro degli Affari Esteri i commerci della regione: "il y a environ 100 negotiants, lesquels […] une fois de l'année chargeront pour Venise"[13].

Appare chiaro che, verso la fine del secolo, la città ha ripreso un attivo ruolo navale e commerciale, creando problemi di concorrenza con altri importanti porti dell'Adriatico e divenendo, forse, il porto principale për l'Albania centrale.

[8] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol II, doc. 170, 228.
[9] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol II, doc. 175, 254.
[10] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol IV, doc. 1, 13.
[11] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol IV, doc. 27, 67.
[12] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol IV, doc. 33, 12-13.
[13] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol IV, doc. 228, 476.

Le caratteristiche di composizione del deposito monetale possono dare origine a diverse ipotesi interpretative. Quella apparentemente più ovvia, di un semplice deposito 'da attività lavorativa', abitualmente utilizzato dal proprietario për riporre gli eventuali ricavi giornalieri e për il prelievo di denaro për le spese correnti, è del tutto inficiata dalla sua composizione. Manca, infatti, completamente ogni altro tipo di moneta localmente corrente, in particolare gli aspri turchi o eventualmente moneta veneziana; almeno gli aspri, plausibilmente, non sarebbero mancati se il prelievo dal circolante fosse stato effettuato in maniera casuale. Al contrario, le monete provengono tutte da un'unica zecca straniera e rappresentano un unico tipo di nominale. Oppure il deposito potrebbe essere il risultato di un'unica operazione commerciale di una certa rilevanza, lecita o illecita, legata forse alle attività del porto di Durazzo. Questa seconda eventualità non contrasta col fatto che un certo numero di monete siano forate, dal momento che il loro valore intrinseco, in questo caso, resta inalterato. Un'ulteriore possibilità è quella che vede il deposito come il risultato di un rastrellamento sistematico del grosso raguseo, effettuato a scopo speculativo sul circolante della zona, dopo la comparsa in Ragusa del nuovo e svalutato "grossetto" a partire dal 1626. Lo scopo, in questo caso, fu di raccogliere un certo quantitativo d'argento da vendere, eventualmente a peso, come bolzone, oppure për cambiarlo, come moneta maggiormente valutata sul mercato locale, con qualche altro tipo più frequentemente presente a Durazzo. È inoltre possibile che il grosso di Ragusa, con le sue rappresentazioni inerenti la fede cristiana, circolasse con difficoltà o sospetto nei territori sotto il controllo turco.

Conviene spendere alcune parole a proposito degli esemplari bucati, i quali sul totale delle monete rappresentano circa il 10% dei pezzi. Il grande capitolo degli usi extracommerciali della moneta, nei suoi 25 secoli di presenza e d'uso presso la

società umana, è ben noto dalla letteratura[14]. La stessa forma rotondeggiante della moneta, il valore intrinseco del metallo, le raffigurazioni su di essa riportate e gli usi e costumi delle società presso le quali ha convissuto, l'hanno resa conveniente ad una serie di molteplici funzioni. Si ricorda succintamente la sua funzione nelle tombe, da riconoscersi non solo come "obolo di Caronte", la capacità talismanica ed apotropaica ad essa attribuita, perfino in epoca cristiana, la funzione di offerta nei templi e successivamente analogamente lasciata sugli altari dai pellegrini, la sua deposizione come memoria e testimonianza nei riti di fondazione degli edifici sacri e pubblici, l'utilizzazione come reliquia e icona, o adattata, talvolta, a strumento d'uso quotidiano, fino ad essere gettata a scopo propiziatorio nella Fontana di Trevi o lasciata dagli astronauti sulla Luna.

Oltre a queste, una funzione fondamentale della moneta, che ritroviamo in usi antichissimi e documentati, sia për aree greche che romane, scandinave, "barbariche" e ancora oggi viva, è quella rappresentata dalle collane e dai gioielli, soprattutto femminili. L'uso ornamentale è indotto dalle raffigurazioni, dalla loro lucentezza, dal desiderio di ostentare l'opulenza e il benessere economico. Raramente furono, infatti, utilizzate a questo scopo monete in metallo vile. Nei pezzi del nostro ritrovamento, i fori sembrano praticati in modo casuale, senza aver riguardo alla posizione che avrebbero eventualmente assunto le figure di Cristo o di San Biagio. In alcuni casi, anzi, il foro ne deturpa in maniera evidente le immagini.

L'ipotesi più verosimile è dunque che esse siano state utilizzate come ornamento për accessori femminili, secondo una pratica diffusa ancora oggi. Lunghe file di monete compaiono

[14] Per una più ampia conoscenza dell'argomento, PERASSI 2005 e TRAVAINI 2007 ne trattano diffusamente, sia per l'antichità sia per le epoche successive.

cucite sui caratteristici costumi etnici delle donne della regione (Fig. 23).



Fig. 23 - L'uso delle monete cucite sugli abiti femminili a scopo decorativo (da Arti Popullor në Shqiperi 1976)

Tale usanza doveva essere già diffusa nel XVI secolo, se Carlo Ranzo, gentiluomo di Vercelli, in un passo della sua cronaca redatta nel 1575, mentre accompagnava a Istanbul Giacomo Soranzo ambasciatore di Venezia, illustrando le genti incontrate nel Montenegro, scrive che "le donne nere, forti e

gagliarde più delli uomini, [indossavano] tre giri d'aspri al collo e alle bracce come manighe, e alla valuta d'un zecchino në bisognavano 60, essendo moneta d'argento"[15]. Non è difficile imbattersi oggi, sul mercato antiquario, in esemplari forati provenienti dalla penisola balcanica, come testimoniano due lotti posti in vendita sul Web negli ultimi anni[16].

Un'ultima riflessione riguarda la possibile datazione del deposito. Le monete più recenti appartengono al tipo 47 di Mimica e furono coniate fino al 1621, per essere sostituite dal 1626 con la coniazione da parte della zecca di Ragusa dei "grossetti" datati, ridotti in peso ed in intrinseco d'argento. Il momento dell'occultamento deve, pertanto, essere posto successivamente al 1621.

Il fatto poi, che anche 38 esemplari dell'ultimo tipo risultino forati, në fa posticipare di qualche tempo la chiusura. È, infatti, possibile che queste monete forate siano entrate a far parte del deposito non solo dopo essere state preparate, ma dopo avere già svolto una, sia pur breve, funzione ornamentale, prima di essere tesaurizzate assieme alle altre, estromesse dalla circolazione dal nuovo e svalutato "grossetto".

BIBLIOGRAFI

Arti Popullor në Shqipëri 1976 = Zojzi G., Dojaka A., Qatipi H. (eds.), Arti Popullor në Shqipëri, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Istituti i Historisë - Sectori i Etnografie, Tiranë.

[15] Dokumente të shekujve XVI-XVII, vol I, doc. 247, 331.

[16] Un primo stock è costituito da 47 pezzi, tutti forati: l'offerta viene da Skopje e le monete che costituiscono il lotto (tutte straniere alla Macedonia, anch'essa all'epoca sotto dominazione turca) si datano tra fine XVI ed inizi XVII secolo, con prevalenza di monete polacche (artilucchi), ma con la presenza di almeno un grosso di Ragusa. Un secondo lotto comprende 29 grossi e "grossetti", tutti della zecca di Ragusa e tutti forati

CNI 1922 = Corpus Nummorum Italicorum, vol. VI: Veneto (zecche minori), Dalmazia-Albania, Roma.

Dokumente të Shekujve XVI-XVII = Zamputi I. (ed.) 1989-1990, Dokumente të Shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, 4 voll., Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Historisë, Tiranë.

Mimica B. 1994, 'Numizmatička povijest Dubrovnika', Historia Ragusina in Nummis, Rijeka,

Perassi C. 2003-04, 'Usi "non monetali" delle monete romane. Monete gioiello, monete talismano, monete offerta', Colloqui di Numismatica I, Bologna, pagine 37-49.

Prokisch B., Emmerig H., Heintz M., Zavadil M., Heinz S. 2000, Repertorium zur Neuzeitlichen Münzprägung Europas, Band XVIII - Südosteuropa, Institutes für Numismatik, Ëien.

Režetar M. 1905, 'Le monete della Repubblica di Ragusa', Rivista Italiana di Numismatica XVIII, pagine 215-230

Režetar M. 1924-25, Dubrovacka numizmatika, Beograd.

Režetar M. 1936, 'La zecca di Ragusa nel Corpus Nummorum Italicorum', Rassegna Monetaria 33, pagine 454-458

Travaini L. 2007, Monete e storia nell'Italia medievale, Roma.

Informacion paraprak mbi zbulimin e një thesari monedhash raguzane (grosse) në amfiteatrin e Durrësit

(Përmbledhje)

Zbulimi. Gjatë fushatës së gërmimeve të vitit 2006, të kryer në amfiteatrin e Durrësit nga Instituti i Arkeologjisë Tiranë dhe Misioni Arkeologjik Italian i Universitetit të Parmës, u zbulua një thesar i përbërë nga 549 monedha raguzane, të prera midis gjysmës së dytë të shek. XVI t dhe vitit 1621.

Zbulimi (njesia stratigrafike US 52) u identifikua në kthinat A-C të Rezidencës mesjetare, mbi mbetjet e shembura të pjesës jugore të kavesë së amfiteatrit dhe të banuara, me rinovime të shumta, deri rreth tridhjetë vjet më pare (Fig. 1). Monedhat ruheshin në një enë qeramikeme glazurë të shek. XVI (Fig. 2); Ena, e vendosur poshtë një pllake dyshemeje (US 180, ose në nënbazën US 261), bazuar në analizën diagnostikuese, datohet në shek. XVI-XVII

Monedhat të përfshira nga një oksidim i lartë, ishin të palexueshme. Por, pas restaurimit nga Prof. Frederik Stamati, rezultoi se brenda në enë monedhat ishin mbështjellë me një qese prej cohe (kanavace?). 53 copë prej tyre u gjetën me vrima dhe të grupuara veçmas nga të tjerat.

Monedhat. Thesari përbëhet nga 549 monedha argjendi të prera nga punishtja e së Raguzës (sot Dubrovnik). Koleksioni i përket një tipi monedhe që, në tekstet numizmatike, quhet "grosso" (ose dinar). Me përjashtim të një ekzemplari të vetëm më të vjetër, pjesa tjetër e thesarit përfshin një periudhë kronologjike nga gjysma e dytë e shek. XVI deri në vitin 1621. Në vitin e fundit, emërtimi i grossos pati ndryshime të pjesë-

shme me emetime të reja. Ky ndryshim u shoqërua me një ulje të aliazhit dhe të peshës. Që nga kjo kohë e në vijim, është zakon t'i referohemi kësaj prerjeje si "grossetto" (dinarić).

Grosso e Raguzës filloi të pritej në Raguzë në vitin 1337. Vlera e saj ishte 30 folar (ose minça). Fillimisht, peshonte 1.8 g, kishte një diametër prej 19-20 mm dhe një pastërti prej 916 ‰ argjendi. Megjithatë, deri në dy dekadat e para të shekullit të XVII, reduktimet progresive e kishin çuar peshën e tij në afërsisht 0.55 g, diametrin në afërsisht 17.5 mm, ndërsa pastërtia ishte ulur në 800 ‰. Nga shek. XIV deri në shek. XVI, grosso i Raguzës qarkullonte me një vlerë të barabartë me dy të tretat e grossos veneciane. Kjo e fundit ishte shpërdarë gjerësisht në të gjithë zonën e gjerë ekonomike të Republikës Veneciane, duke përfshirë rajonet dalmate dhe arbërore.

Tipologjia bazë e grossos, e cila mbeti në thelb e qëndrueshme për më shumë se tre shekuj, është si më poshtë:

- D/ (nga e djathta, lart) S BLASIVS RAGVSII. Shën Blaise, me aureolë, në këmbë përballë, i veshur me rroba peshkopi, duke bekuar me dorën e djathtë dhe një krosier në të majtë.

- D/ pa epigraf. Në fushë, Shpëtimtari me aureolë, në një mandorlë, duke bekuar me dorën e djathtë. Ai mban Librin në të majtë. Në anët e mandorlës, në një pozicion horizontal, janë grupe monogramash për Jezu Krishtin (të shprehura në mënyra të ndryshme në emisione të ndryshme: p. sh., IC-XC, ose IE-XE, etj.)

Në përputhje me politikën monetare të Venedikut, me të cilën Raguza mbante marrëdhënie aktive, përshkrimet mbetën të pandryshuara për një kohë të gjatë, me ndryshime pothuajse minimale në figurën e Shën Blaisit dhe rrobës së tij, si dhe në imazhin e Krishtit.

Disa nga grosët e hershëm mbajnë një shenjë dalluese të prerjes së monedhave në të djathtë të shenjtorit, ndërsa nga viti

1452 e në vijim, u vendos germa 'R'. Megjithatë, në anën e pasme, në numrin e fundit të vitit 1617, Krishti mban një glob në dorën e majtë në vend të Librit, ndërsa shenja e shkurtimit sipër monogrameve, më parë lineare, së fundi merr formën e një omege. Klasifikimi dhe kronologjia e e këtyre monedhave bazohet në përcaktimet e Božan Mimicas, në studimet më të fundit mbi prerjen e monedhave të Raguzës, (shih Tabelën 1).

Në total, 549 monedhat janë renditura sipas tipeve Mimicas si më poshtë:

- Tipi 38 (?): 1 copë; 0.71 g (Fig. 3). Kjo monedhë është e vetmja gjetje që nuk ka një 'R' në të majtë të Shën Blaise.

- Tipi 41 (1539-56): 1 copë, e shpuar. 0.63 g (Fig. 4). Ana e përparme: Shën Blaise në një rrobë; Ana e pasme: në të dyja anët e Krishtit: IЄ-XЄ.

- Tipi 44 (1581-94): 2 copë, të shpuara; 0.62 dhe 0.63 g (Fig. 5). Pamja e përparme: Shën Blaisi me një nuskë greke, mbi të cilën është vendosur një kundërvulë me një imazh të stilizuar të një qyteti; Djathtas/ në anët e Krishtit: IC (ose IX) -XI (ose CI, ose IC, ose XC). Një vulë me kokën e peshkopit (Shën Blaisi) është vendosur mbi figurën e Krishtit.

- Tipi 45 (1591): 1 copë, fragmente të shpuara dhe që mungojnë (Fig. 6). Pamja e përparme: Shën Blaisi me një nuskë romake; Djathtas/ Krishti me një libër. Në anët: IE-XE.

- Tipi 46 (1594-1613): 27 copë, 11 prej të cilave janë të shpuara (Fig. 7). Pamja e përparme: Shën Blaisi me një nuskë greke, mbi të cilën është vendosur një imazh i stilizuar i qytetit, jo si kundërvulë, por i gdhendur gjatë prerjes; Pamja e pasme: Koka peshkopale e Shën Blaisit e shtypur në gjoksin e Krishtit; Në anët e Krishtit: IЄ-XЄ.

- Tipi 47 (1617-21): 515 copë, 38 prej të cilave janë të shpuara (Fig. 8). Pamja e përparme: Shën Blaisi me një rrobë romake me një kryq të madh, duke mbajtur imazhin e qytetit në

dorën e majtë; Pamja e pasme: Krishti duke mbajtur globin në dorën e majtë; në anët: IЄ-XP. Shkurtimet janë në formë omege.

- Nga kolesioni janë dy monedha të paklasifikueshme.

Njëzet e katër monedhave u mungojnë disa fragmente. Disa prej tyre, të thyera në dy ose më shumë pjesë, u restauruan pas pastrimit. Disa shembuj tregojnë shenja të korrozionit sipërfaqësor, i cili që ka ndikuar në krijimin e vrimave të vogla.

Monedhat më të hershme (tipet 38, 41 dhe 44) duket se kanë një sasi të konsiderueshme konsumimi nga qarkullimi, ndërsa shumë copë nga emetimi i fundit (tipi 47) janë në gjendje të mire, me pak gjurmë konsumimi.

Monedhat e shpuara - të cilat përbëjnë pothuajse të gjitha tipet më të hershme përbëjnë afërsisht 40% të tipit 46, ndërsa një pjesë e vogël (7.5%) e emisionit të fundit janë të shpuara.

Vrimat në monedha kanë prerje tërthore të ndryshme dhe duket se janë bërë me mjete të ndryshme: një gozhdë ose fëndyell me një prerje tërthore të rrumbullakosur, katrore ose trekëndëshe, ose me goditje nga një prerës.

Lidhur me groposjen e thesarit na vijnë në ndihmë prerje më të fundit që, sipas Mimicas i përkasin Tipit 47, të prera deri në vitin 1621, që më pas, në vitin 1626, u zëvendësuan nga prerja e "grossettit". Prandaj, koha e fshehjes së tyre duhet të datohet pas vitit 1621.

Disa Hipoteza. Në shekujt XVI dhe XVII, qyteti i Durrësit përfshihej midis njësive administrative-ushtarake otomane. Në veprën *L'Ottomanno* të L. Soranzos, botuar në Ferrara në vitin 1598, thuhet: " Durrësi nuk ka liman të përshtashëm për galera, dhe ujërat e cekëta në hyrje janë shumë të rrezikshme." I njejti konstatim bëhet edhe nga J. Kotovich në “Itinerarium Hierosolimitanum”, i cili thotë se: Durrësi "ishte një qytet i vogël, gjysmë i rrënuar". J. Spon dhe G. Wheler e përfytyronin se

qyteti do të ishte "si Dyrrachiumi i Romakëve" por faktikisht është vetëm një fshat me një fortesë të rrënuar".

Për këto arësye më 1686, qeveria e Raguzës i dërgoi një kërkesë private Portës së Lartë, duke kërkuar "mbylljen e portit të Durrësit" sepse "të gjitha mallrat do të shkonin domosdoshmërisht nëpërmjet portit të Raguzës".

Disa muaj më vonë, Senati i Raguzës i kërkoi përfaqësuesit të tij pranë Pashait të Bosnjës, të kryente të njëjtin operacion të mbylljes së portit të Durrësit.

Në vitin 1699, konsull francez i Durrësit informonte Ministrin të tij të Punëve të Jashtme: për tregtinë e rajonit, se, "ka rreth 100 tregtarë, të cilët [...] ngarkojnë për Venedikun një herë në vit".

Është e qartë se, në vitet e fundit të shek. XVII, qyteti rifilloi gradualisht, një rol aktiv detar dhe tregtar, duke u bërë porti kryesor për Shqipërinë qendrore, në konkurrencë me porte të tjera të rëndësishme të Adriatikut

V

ASPEKTE TË PËRHAPJES SË KRISHTERIMIT NË PROVINCËN E EPIRIT TË RI[1]

Epirus Nova's ka qenë një nga provincat romake[2] të Prefektures së Illyricumit, ku gjeti përhapje krishtërimi i hershëm. Gjatë kohës apostolike dhe postapostolike (nga fillimet deri nëfund të shek. I të erës sonë) [3], në territoret e Ultësires Pranë-adriatike e më gjerë, sipas burimeve historike, kanë apostulluar 3 ose 4 dishepuj (Titius, Caesarius, Astius etj.) [4] duke mbuluar secili nga një rajon kulturor.

Bashkësia kristiane e kolonisë së Dyrrhachiumit në gjysmën e dytë të shek. I të erës sonë përfaqësonte një ndër vatrat e para të kishave me themelim apostolik, duke u renditur fill pas qendrave peshkopale të ngritura në qytetet Thessaloniki, Corinthos, Nikopolis dhe Creta[5].

[1] Marrë nga HOTI A. Aspekte të përhapjes së krishtërimit të hershëm në Provincën e Epirit të Ri, "2000 Vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri (Tiranë, 16-18 nëntor 2000), Tiranë 2005 f. 23-28.

[2] E. Honingman, "Le Synekdemos d'Hierokles et l'opuscule geographique de Georges de Chypre" Bruxelles 1939, 2, 19-21, 620.

[3] "Act. Apostol", 16, 1-40; 17, 1-15; 20, 1-6, E. Meyer, "Paulus in Makedonien und Griechenland" (Ursprung und Anfänge des Christentums) III (1923), 427-432.

[4] H. Delehaye, "Synax. Eccl. Const, A. S. Prop. nov. Bruxelles, 1902, col. 797, 801, 806; AASS", jul. 5, 6; "PG", CXVII, 526-7; "Ap., Mart., 9. 12. 198; V. Laurent, "Le Corpus des Sceau se l'Empire Byzantin", Paris 1963, 560-563.

[5] La chiesa ortodossa Albanese "Oriente Cristiano" 4, 1978, 14.

Të dhënat arkeologjke të përftuar në këto dhjetëvjeçaret e fundit kanë dëshmuar se gjatë periudhës së kalimit nga faza Parakonstandiniene (nga fillimet deri në vitet 311-313) në atë Konstandiniene (313-340) ishin ndërtuar kështjellat në Dyrrhachium[6], Scampis[7] dhe Paleokaster[8]. Religjioni i ri pati një rreze përhapje ende të kufizuar edhe gjatë fazave Paskonstandiniene (340-360/370) dhe Valentinieno-Theodosiane (360/370 -400).

Periudha gjatë së cilës krishterimi i hershëm arriti zenitin e tij ishte koha e mbretërimit të perandorëve bizantine nga Anastasius I (491-518) [9] gjer në fund të sundimit të Justinianit I (527-565) [10], (faza e kohës së vonë, pas vitit 400). Gjatë kësaj periudhe në proceset e zhvillimit urban të qyteteve kristiane u vunë re dy prirje: a-rimëkëmbje e rrethojave të mëparshme duke ruajtur linjat ndërtimore që nga koha e perandorit Dioklician (284-305)[11]; b-ndërtimi i një sistemi të ri fortifikimesh dhe ngrehinash në përputhje me principet e reja të arkitekturës bizantine[12].

Në të gjithë hapësirën ku shtrihej provinca, (nga lumi Drin deri në malet Keraune në jug dhe nga bregdeti Adriatik drejt

[6] Gj. Karaiskaj-A. Bace, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë, "Monumentet" 9, 1975, f. 8.
[7] Gj. Karaiskaj, "5000 vjet fortifikime në Shqipëri", Tiranë 1981, f. 110, fig. 81; S. Anamali, Architettura e decorazione tardoantica in Albania, XL corso di cultura sull'arte Ravennate e Bizantina, Ravena 1993, f. 448, 457, 469.
[8] Gj. Karaiskaj, "5000 vjet…," f. 108, fig. 78.
[9] A. Hoti, Të dhena arkeologjike mbi krishtërimin e hershëm në Dyrrah (shek. IV-VII), "Iliria"1-2, 1996, f. 175-176.
[10] S. Anamali, "Epoka e Justinianit në Shqipëri", "Iliria" 1-2, 1997; A. Hoti, art. cit. f. 175-178.
[11] Gj. Karaiskaj, po aty.
[12] A. Hoti, art. cit. f. 175-179.

lindjes deri në liqenin e Ohrit), (Fig. 1) janë zbuluar ose ruhen mbi 50 kështjella të fazës së kohës se vonë paleokristiane[13].




Fig. 1. Hartë e Provincës së Epirit të Ri. (Punoi A.Hoti)

[13] Gj. Karaiskaj, "5000 vjet…," f. 101-124; S. Anamali, art. cit. f. 448, 451, 453.

Në vartësi me terrenin mbizotëron tipi i kështjellës me strukturë të shpërndarë, planimetria e të cilave ndjek formën e një trapezi, katerkendëshi ose trekendëshi të parregullt. Ndryshe nga castrat romake, qytetet bizantine të provinces Epirus Nova's (Dyrrhachium Bylis, Pulcheriopolis, Aulona, Amantia, Pogradec, Lychnid etj.) kanë përmasa më të mëdha[14] (10 deri 80 ha). Ndërsa qendërbanimet me siperfaqe më të vogël (Dorzi, Dajti etj.) [15] shërbenin si hallka asteroide për mbrojtjen e kryeqendrës së provincës (Dyrrachumit).

Në qytetet seli-peshkopale por edhe në shumë qendra rurale, gjatë viteve 500-560 u ngritën një numër i madh me godina të kultit kristian[16]. Ato u ndërtuan jo gjithherë në sheshe të reja, por edhe në zona të banuara më parë. Në ndonjë prej qendërbanimeve si në Scampis, Amantia e gjetkë, ndryshe nga qytetet e tjera, pati raste që kishat më të herëshme të ndërtoheshin jashtë mureve të kështjellës[17].

Dyrrachiumi ishte një nga qytetet e para ku u vendosën kolonët italikë të familjes Aemilia. Pas vitit 30 p.e.s., në burimet historike, kolonia e Dyrrachiumit përmendet në dokumente të shumta me emërtime të tilla si: "Colonia Julia Augusta", "Colonia Julia Veneria" dhe "Colonia Julia Augusta Veneria Dyrrachinorum" (Shpuza, S. 2014).

Dyrrachiumi shquhej si kolonia ku parimet romake të ndërtimit u zbatuan për herë të parë në Ballkanin Perëndimor, duke transformuar jetën e qytetarëve, përmes futjes së stilit të jetesës romake përdorimit të banjove termale, ujësjellësve dhe përmisimit të shërbimeve të tjera higjeno-sanitare.

Në veprën e Plautit, "Menaechmi", lexojmë se "qyteti karakterizohej nga një kulturë universale romake", duke qenë kështu pjesë e familjes së madhe mesdhetare (Hoti, A. 2006: 22).

Qyteti përjetoi një epokë të artë, sidomos përgjatë dinastisë së Antoninëve (shek. II pas Kr.), kur u ndërtuan disa objekte: si amfiteatri, biblioteka, termat publike, ujësjellësi dhe një sërë vilash luksoze (Santoro, S. 2003).

Gërmimet arkeologjike të kryera në dekadat e fundit, kanë kanë nxjerrë në dritë disa rrënoja të termave dhe të impianteve sanitare.




Fig. 1. Termat, shek II mbas Kr. (Foto nga V. Toçi)

Termat Publike (Fig. 1), ndërtuar në shek. II pas Kr., gjenden nën themelet e teatrit aktual të qytetit. Ndër mjediset e tyre, të ruajtura mirë janë: "Caldariumi" me përmasa 13x8 m, "Tepidariumi", i shtruar me mermer të zi e të bardhë, pishina dhe "apodyteriumi". (Miraj, L. 1994).

Terma private (Lagjja nr. 11), e zbuluan më 2002, ku strukturat ("Apodyterium", "Frigidarium", "Tepidarium", "Caldarium" etj. me gjatësi 20 m dhe gjerësi 8 m) ruheshin gjithashtu në gjendje të mirë (Hoti, A. et al. 2004). Në pjesën lindore, termat ishin të pajisura me tri "praefurnia" dhe një furrë, e cila furnizonte sistemin e ngrohjes.

Ujësjellësi përbën veprën më të madhe hidroteknike të periudhës romake të zbuluar në Shqipëri. Ai merrte ujë nga lumi Erzen, 15 km larg Dyrrachiuit. Në zonat e ulëta kishte harqe me diametër 3,90 m, ndërsa kanali kalonte në shpatin e kodrës së Arapajt përmes një tuneli 2600 metra të gjatë Kur arrinte në

fushë, në hyrje të qytetit, uji shpërndahej në një rrjet tubacionesh plumbi. Emri i perandorit Hadrian është stamposur në disa prej tubacioneve të ujësjellësit (Miraj, F., Myrto, H. 1982).

Segment i një kanali antik (Lagjja nr. 11), është zbulur në thellësi prej 3, 90 m, Kanali, me gjatësi 4,90 m, gjerësi 1,57 m dhe lartësi të brendshme 1, 13 m, ë shtë ndërtuar me tulla me përmasa 29x37x4,7 cm dhe llaç të fortë (Tartari, F. 1981).

Gjatë gërmimeve arkeologjike, krahas rrënojave, janë zbuluar shumë artefakte, si vepra arti, pajisje me forma të veçanta, instrumente medicinale, që hedhin dritë mbi aspektet e zhvillimit të mjekësisë të kësaj periudhe.

Përhapja e kultit të Asklepit, në koloninë e Dyrrachiumit, pati një ndikim të veçantë, jo vetëm në ndërtimin e Tempullit të kësaj hyjnie, por edhe në vepra të tjera si ujësjellësit, banjot publike, sistemet e kanalizimeve etj. Arkitektura, skulptura dhe artizanati u zhvilluan paralelisht si një frymëzim dhe përkushtim për kultin e perendisë së mjekësisë.

Gjatë dy shekujve të parë mbas Kr., u krijuan vepra arti kushtuar adhurimit të Asklepit. Për kryerjen e riteve të adhurimit përdoreshin edhe objekte me karakter apotropeik (mbrojtës), si ato që lidheshin me magjitë, syrin e keq, parashikimin e së ardhmes etj.

Herma e Asklepit (Fig. 2), me lartësi 37 cm, gjetur në Durrës, është punuar në gur gëlqeror të bardhë. Busti i tij është realizuar në mënyrë të njëtrajtëshme dhe natyrale së bashku me bazamentin mbështetës. Një nga tiparet e skulpturës është mjekra e rrumbullakosur, një detaj i rëndësishëm i kësaj hyjnie. Në pjesën ballore të bazamentit është rë ravizuar një mbishkrim prej dy rreshtash në gjuhën greke: Ασκληπιός (Asklepios).



Fig. 2. Herme e Asklepit, shek II para Kr. (Foto nga A. Kavaja)

Në punishtet romake, përpunimi artistik i metalevee argjentaria, arriti nivele të larta mjeshtërie. Mes gjetjeve arkeologjike që tërheqin vëmendjen, dallohen disa ekzemplarë të vecantë. Një nga shembujt më të spikatur është një unazë me gemë, që paraqet Hygenë dhe Asklepin, të shoqëruar nga simbole të ndryshme të këtij kulti. (Fig. 3).




Fig. 3. Sfondi i Gemës së unazës prej ari, shek. III para Kr.
(Foto nga A. Kavaja)

Gema, e punuar imtësisht sipas teknikës së gliptikës, paraqet ambientin e brendshëm të tempullit të Asklepit. Në qendër të ambjentit ndodhet Hygea (e bija e Asklepit), perëndesha e shëndetit. Ajo është ulur në një poltron, mban në dorën e djathtë një kurorë, e pozicionuar përballë statujës së Asklepit. Tek figura e Asklepit, i cili qëndron ulur në mënyrë madhështore mbi një piedestal të lartë, bie në sy mjekra e tij karakteristike.

Përballë Hygesë gjendet një tavolinë e thjeshtë, mbi të cilën është vendosur një enë. Mes altarit të Asklepit dhe këmbës së tavolinës, është një qen, ndërsa pranë saj, ngrihet një skeptër, me një gjarpër i mbështjellë rreth tij.

Përmbajtja artistike e gemës dhe elementet të tij, si tavolina, gjarpëri dhe qeni, lidhen ngushtë me kultin romak të Asklepit.

Argjendarët e talentuar të punishteve të shek. I-II pas Kr., për nevojat e kirurgjisë dhe mjekësisë së përgjithshme, prodhuan edhe një sërë instrumentash të rëndësishme mjekësore. Në grupin e këtyre objekteve gjejmë: piskatore bronzi dhe sonda në formë gjethi, të cilat përdoreshin për futje nën lëkurë, duke lehtësuar prerjen me bisturi; shigjeta me majë, për të pastruar plagët e infektuara; lugë kockash për dozimin e barnave; tuba dhe enë qelqi, etj. Mes tyre spikat një peshore farmacie në formë piramidale, e punuar në gur të zi (Tartari, F., Bllaca, H., 1989).

Në grupin e enëve përfshihen forma në miniaturë që imitojnë "aryballos", "askos"e, shishe të vogla (për vajra mjekues ose parfume), pikside, etj. Në këtë seri gjejmë gjithashtu objekte të veçantë të punuar prej qelqi, fildishi, kocke, mermeri dhe alabastri.

Në fondet e Muzeut Arkeologjik të Durrësit, nga arkivi i V. Toçit, gjendet një piksidë, në relievin e jashtëm të të cilit paraqiten tre Erosët (Fig. 4).

Duke filluar nga shek. I pas Kr., enët prej qelqi dhe objektet e përdorur nga klinikat e kohës antike, filluan të qarkullonin gjerësisht edhe në Dyrrachium.

Autorët antikë, por edhe gjetjet arkeologjike, dëshmojnë se në Dyrrahun antik ushtronin profesionin mjekë të përgjithshëm, si dhe specialistë të fushave të veçanta.

Arritjet e mjekësisë Dyrrahase tërhoqën vëmendjen e disa dijetarëve romakë. Kështu, në veprën e Plinit Plak (C. Plinius Secundus), "Naturalis Historia", përmenden disa barna (si irisi, "saliunca", etj.) që përdoreshin si për parfume, ashtu edhe për kurimin e sëmundjeve të ndryshme, madje edhe kundër zgjebes.

Kjo përvojë e pasur në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme përmes bimëve mjekuese i dha mundësi, një mjeku të quajtur, Filonidit të Dyrrahut (shek. I para Kr., nxënës dhe dishepull i

mjekut të gjithanshëm Asklepiad nga Bitinia) të botonte 45 traktate mbi tema mjekësore. (Stephanos of Bizantium, Dyrrachion).



Fig. 4. Piksidë, shek. I-II mbas kr. (Foto nga A.Kavaja)

Bibliografi:

1. Deniaux, E. 1988. Cicéron et la protection des cites de l'Illyrie du sud et de l'Épire, dans Iliria, 2, 1988, p. 143-146.

2. Deniaux, E, 2012. Épigraphie et construction publiques dans la colonie de Dyrrachium, dans 0

S. Demougin, J. Scheid (éd.), Colons et colonies dans les monde romain, Rome, 2012 (Collection del'École française de Rome, 456), p. 219-228.

3. Hoti, A. 2006. Epidamnus - Dyrrhachion- Durrës. pp. 22-24.

4. Hoti, A., Metalla E., Shehi, E. 2004., " Recentissimi scavi archeologici a Durazzo, 2001-2003, in M. Buora, S. Santoro (eds.), Progetto Durrës. Atti del secondo e terzo in-contro scientifico. Strumenti della salvaguardia del patrimonio culturale. Carta del rischio archeologico e catalogazione informatizzata: esempi italiani ed applicabilità in Albania (Parma-Udine 27-29 marzo 2003). Alte tecnologie applicate all'archeologia di Durrës (Durrës 22 giugno 2004)", Antichità Alto-adriatiche, 58, Trieste, pp. 514-516.

5. Miraj, F. Myrto, H. 1982. Ujësjellësi i Dyrrahut, Iliria, 1, pp. 131-156.

6. Miraj, L. 1994. The thermae of Dyrrah, "Iliria", 1-2, f. 207-224.

7. Santoro, S. 2003. Lo stato degli studi sull'urbanistica di Epidmanos-Dyrrachium, "Antichita Adriatica. pp. 149-208.

8. Shpuza, S. 2014. "Colonia Iulia Augusta Dyrrachinorum" Mélanges de l'École française de Rome – Antiquité 126–2. pp. 3-4

9. Tartari, F., Bllaca, H, 1989. Archaeological medical material from Durrës, "Iliria", 1, pp. 261-265.

10. Tartari, F. 1981, Les canalisations dans l'anciene ville de Durrës, "Monumentet", 1, pp. 51-68.

Abstract

The community of the ancient city of Dyrrachium considered the thermals, the aqueducts, the sewers not just hydro-sanitarian works, but also hope for the future of the city– colonial (30 AC. -286 D. C.) protectorate (228 - 30 A. C.). Since the arrival of the Romans during the epoch of Antonimi (2nd century) there were built several buildings, such as the amphitheatre, the library, the public thermal baths, the aqueduct and several luxurious villas. In recent decades, archaeologists have discovered ruins of thermal baths and sanitary works in the city of Dyrrachium. During the archaeological excavations, together with the archaeological ruins, there were discovered many artefacts like those works of art, equipment of particular forms, instruments, symbols, etc., all within the field of medicine; thus they shed light on the aspects of the period development. Achievements in medicine in ancient Dyrrachium, captured the attention of some Roman scholars. Thus, in his book C. Plin Secundi "Naturalis Historia" some drugs are mentioned (like iris, saliunka etc.) which have been used both for perfumery and for the healing of various diseases, even against scabies.

IX

ZGËRDHESHI DHE KRUJA, DY QYTETE TË VAZHDIMËSISË ILIRE-ARBËRORE[1]

1. Qyteti ilir i Zgërdheshit

Kur studiuesi i njohur austriak J. G Hahn, më 1854, vizitoi muret e lashta në Zgërdhesh, pas shumë hulumtimesh, arriti të supozojë se kishte rënë në gjurmë të ruajtura të qytetit antik të Zgërdheshit.

Rrënojat e qytetit ilir të zbuluar në Zgërdhesh ruhen sot në kodrën e Kakariqit, disa kilometra në jugperëndim të Krujës. Zgërdhesh është një fshat nën juridiksionin e Bashkisë së Fushë-Krujës. Fshati është i njohur në të gjithë rajonin për bukurinë e tij natyrore: peizazhin mbresëlënës, i dendur me ullinj, pemë frutore dhe burime të tjera.

Studimi i parë topografik i mureve antike të Zgërdheshit u përfundua në vitin 1919 nga austriakët (Praschniker, Schober, 1919). Pas hulumtimit, ata publikuan një planimetri të sistemit të fortifikimit, në trajtë elipsi me përmasa 300x120m.

[1] Marrë nga: A. Hoti, Zgërdhesh and Kruja, two cities Illyrian-arbër continuity" Skills and Tools to the Cultural Heritage and Cultural Tourism Management- Papers collected and coordinated by Sara Santoro in the framework of Tempus IV project, II Vol., Edizioni d'Errico, Teramo -2015, pp. 219-226(ISBN 978-88-97017-08-0) 12).

Gjatë viteve 1969-1973, gërmimet arkeologjike të drejtuara nga Prof. Selim Islami, nxorën në dritë një sërë strukturash arkitekturore, nga të cilat u nxorën disa përfundime (Islami 1972, 1974, 2008). (Fig, 1)

Pas katër vitesh gërmimesh të suksesshme, u nxorën në dritë disa struktura arkitekturore: mure mbrojtëse, ndërtesa të ndryshme, një ndërtesë e kështillit bashkiak, një kishë paleo-kristiane, etj. (Fig. 2).

Muret rrethuese, me gjatësi 1400m, janë konfiguruar në formën e një elipsi dhe janë ndërtuar për t'iu përshtatur formës së kodrës. Sistemi mbrojtës është i përforcuar me kulla katërkëndëshe, të vendosura në çdo 29 m. Fortifikimet e Zgërdheshit u ndërtuan në tre faza ndërtimi.

Periudha e parë përfaqësohet nga muri i vjetër i Akropolit, i ndërtuar me gurë gjysmë të përpunuar. Periudha e dytë ndodhi kur qyteti u zgjerua në një pjesë të fundit të kodrës dhe muret u ndërtuan me blloqe guri të punuara me teknikën "rustike" (banda anësore të gdhendura në formë kornize).

Stili i ndërtesave është i ngjashëm me strukturat mbrojtëse të qyteteve të tjera ilirike në jug, si Lisi, Antigona, Mavrova, etj. (Ceka 1975).

Rrugët e brendshme lidhin pjesë të ndryshme të qytetit me hyrjet, ndërsa shkallët janë të gdhendura në shkëmb për të lehtësuar ngjitjen e këmbësorëve. Pranë rrugëve janë kanalet e një rrjeti hidro-sanitar, disa prej të cilave janë të gdhendura thellë në shkëmb. Tre porta i shërbejnë sistemit të fortifikimit. Në anën jugore është një portë (e shënuar me shkronjën "Q"). Ajo është e bashkangjitur në një korridor të harkuar (1.80 m. i gjerë), ngjitur me akropolin. Në anën perëndimore ndodhet një tjetër korridor më i vogël (rreth 1.30 m i gjerë), i cili është i shtruar me pllaka guri.

Brenda hapësirës së hapur të qytetit ka gjurmë të shumta muresh me tarraca, të cilat forconin parcelat e krijuara për

ndërtimin e shtëpive dhe ndërtesave shoqërore. Në një katror të gdhendur direkt në gur, në formë gjysmërrethore, supozohet se ndodhej një (ndërtesë e këshillit të qytetit). Gjatë gërmimeve, u gjetën mbetje të tre punishteve të prodhimit të qeramikës dhe të një mjedisi për metalurgji (farkë). Materialet e mbledhura brenda këtij mjedisi dëshmojnë qartë për disa aspekte të zhvillimit të zejtarisë në këtë qytet. Midis enëve prej balte, në një hambar të madh të tipit pitos (shek. III-II para Kr.) është stampuar një vulë epigrafike e poçarit me shkronjat "AP", që mendohet se ka ardhur nga një punishte për qeramikë të tipit hambar.




Fig. 1. Qyteti antik i Zgërdheshit (Gërmime të Selim Islamit)

Zbulimi i disa objekteve të tjera me karakter artistik në këtë vend, siç janë terrakotat dhe trupi i një statuje të vogël mermeri (ndoshta Artemisa), ka të rhequr vëmendjen në kërkimin e gjurmëve të një tempulli pagan (Islami 1972).

Nga këto rezultate u bë e mundur të përcaktoheshin tiparet urbane të kësaj qendre ilire që i përkiste nivelit ekonomik dhe kulturor të grupit të qyteteve që zhvilluan urbanizimin. Të dhënat arkeologjike vërtetuan se jeta qytetare në Zgërdhesh filloi atje në fund të shek. IV para Kr. dhe vazhdoi pa ndërprerje deri në fund të shek. IV pas Kr.. (Fig. 3).




Fig. 2. Planimetri e qytetit antik të Zgërdheshit(sipas S. Islamit, ”Monumentet” 1971, Nr. 1, f. 25, Fig. 2)



Fig. 3. Kulla veriperëndimore në murin rrethues të Zgërdheshit (gjysma e dytë e shek. IV para Kr.). (Foto: A. Hoti).

Gjatë antikitetit të vonë, përballë trazirave dhe krizave, qyteti u braktis dhe një pjesë e territorit të tij u shndërrua në varreza (Islami 1972).

Gjatë gërmimeve u mblodhën objekte të ndryshme qeramike, qelqi dhe metali. Përveç kësaj, u gjet një koleksion i pasur monedhash nga Dyrrahu dhe Apollonia, të cilat dëshmojnë se qyteti ilir i Zgërdheshit, ishte një aksesor i rëndësishëm ekonomik dhe tregtar për kolonitë e Adriatikut të poshtëm, veçanërisht për portin e madh të Dyrrahut (Islami 1974).

Gjurmët e gjetura në sipërfaqen e kodrës, veçanërisht fragmente enësh të epokës së hekurit, tregojnë se qyteti ishte

zhvilluar si një vendbanim i fortifikuar në periudhën proto-urbane (tipi Gajtan).

Zgërdhesh është i listuar midis fortifikimeve protourbane të rajonit të Pranë adriatikut, së bashku me Kalanë e Dorzit, Margëlliçit dhe Mashkjezës në Fier (Ceka 1982). Në fund të shek. IV para Kr, këtu u ndërtua një qytet i ri, i cili përjetoi një rritje të shpejtë gjatë shek. III-II para Kr. Jeta në këtë qytet vazhdoi gjatë gjithë shek. I pas Krishtit, por nga shek. IV e tutje, sipas të dhënave të nekropolit paleokristian, territori i tij u shndërrua në varreza (Islami 1972).

Zgërdheshi është pjesë e një grupi qytetesh të mirëfillta ilire. Edhe pse kishte një sipërfaqe relativisht të kufizuar (10 ha), prirja arkitekturore dhe mënyra e organizimit të prodhimit në këtë qytet, nuk kishte dallime thelbësore nga qytetet e tjera ilire si Lissus, Bylis, Foinike, Amantia, Antigonea, etj. Zhvillimi ekonomik këtu fillimisht u bë i mundur nga ndikimi i kolonive greke të Dyrrahut dhe Apollonisë.

Ndër gjetjet më të rëndësishme është një koleksion prej 220 monedhash. Shumica (210 monedha) vijnë nga qyteti i Dyrrahut dhe vetëm 10 vijnë nga Apollonia, Lisi, Korkyra e Zezë, Maqedonia, etj. Nga materiali numizmatik, duket qartë se qyteti i lashtë i Zgërdheshit ishte një partner i rëndësishëm ekonomik me qytetin e madh të Dyrrahut. Pjesa tjetër e monedhave, megjithëse të pakta në numër, tregojnë se qyteti kishte shkëmbime tregtare me qendrat e rëndësishme ekonomike ilire në Jug e më gjerë (Islami 1974).

2. Zgërdheshi dhe Kruja – Dy qytete iliro-arbërore

Nga përshtypjet e para të autorëve antikë dhe mesjetarë, toka e Albanit ishte më e zhvilluara e ultësirë s së Adriatikut. Që nga koha kur Ptolemeu e identifikoi për herë të parë Albanopolin në hartën e tij, emri i qytetit ka qenë gjithmonë i pranishëm

dhe i njohur në vendet fqinje. Lidhur me këtë dëshmon një mbishkrim i gdhendur në një monument funeral, i gjetur pranë Shkupit (datuar në fund të shek. I ose në fillim të shek. II pas Kr.) që i përkiste një qytetari ilir nga Albanopoli.

Rezultatet e kërkimit arkeologjik ofrojnë një pamje të qartë se qyteti ilir i Zgërdheshit përjetoi një periudhë të gjatë zhvillimi aktiv nga mesi i shekullit të III para Kr. deri në shek. I pas Krishtit. Aty nga fundi I të shek. IV pas Kr. ai ishte shndërruar në një qendër rurale dhe banorët e tij e kishin braktisur atë për të jetuar në një vend më të sigurt. Duke u mbështetur në një legjendë që thotë se "Gurët e Zgërdheshit u morën dhe ngritën Krujën" (Adhami 1970), ka shumë të ngjarë që në kohët e trazuara të shkaktuara nga migrimet e popullsisë, banorët e Zgërdheshit u zhvendosën në Krujë për të krijuar një qytet më të sigurt për jetesë.

Ne trashëgojmë një burim të rëndësishëm historik rreth albanëve dhe kryeqytetit të tyre Albanopolit nga gjeografi dhe hartografi aleksandrian, Klaud Ptolemeu, (100-178 pas Kr.). Midis qyteteve ilire në veprën e tij "Geographia", ai e vendos Albanopolin në gjerësinë gjeografike 41°5’ dhe gjatësinë gjeografike 46° (Ptolemaeus, Geographia, III, 13: 23). Ashtu siç koinoni i Bylinëve kishte kryeqytetin në Bylis, amantët kishin Amantian, edhe albanët kishin Albanopolin.

Sipas koordinatave të hartës së Ptolemeut, qyteti i Albanopolit dhe rajoni i Albanëve duket shtriheshin midis lumit Mat dhe kodrës së Krrabës. Vendndodhja e Ptolemeut përputhet jo vetëm me pozicionin gjeografik të fshatit Zgërdhesh dhe rrethinave të tij, por edhe me të dhënat arkeologjike dhe toponimike.

Disa autorë të huaj (Hahn 1854, Praschniker 1919) kanë propozuar që origjina e emrit të fisit ilir “alban” i ka rrënjët në rajonin e Krujës, dhe më shumë gjasa në fshatin Zgërdhesh. Kjo

mbetet vetëm një hipotezë derisa të mbështetet nga burime të tjera historike dhe të dhëna toponimike.



Fig. 4. Krujë. Kulla e rojës. Shek. XV (Foto: A. Hoti)

Në kronikat osmane, emri Zgërdhesh përmendet si toponimi Ozgurtas. Sipas disa studiuesve gjuhësorë, emri i fshatrave Zgërdhesh, Bradashesh, Godolesh, Martanesh dhe të tjerë me prapashtesën "esh": (duke përfshirë edhe rajonin e Arbëreshëve) kanë origjinë nga latinishtja romake (Demiraj 1999).

Në kodrat pranë Zgërdheshit gjendet një përrua i quajtur "Përroi i Albanit". Në njërën nga brigjet e këtij përroi ndodhet "Burimi i Albanit" ku sot rrjedh ende ujë i ftohtë nga Mali i

Krujës. Rreth këtij burimi mendohet se ka ende rrënoja të paidentifikuara, të cilat sipas të moçmë ve, duhen kërkuar trojet e stërgjyshërve. Pas migrimit të këtyre toponimeve, është gjithashtu interesant fakti sepse "Përroi i Albanit" kishte depërtuar në "Qafën e Allbanës" jo më shumë se 5 km larg Zgërdheshit, duke zbritur më në jug, në fshatrat Verjon e Zezë, ruhet i njëjti emër. Edhe në fshatin Zezë ku përroi është zgjeruar në formën e një vau, toponimi njihet gjerësisht me emë rtimin "Në va të Malokve -Tallbanës".

Toponimi "Tallbaneja" shfaqet edhe në disa nga tokat bujqësore aty pranë. Për më tepër, në rrethet fqinje të Tiranës, toponime të tilla ruhen edhe sot, si në fshatrat “Arbane” ose “Kodra Allbaone” në Bërxullë (Luka 1988).

Në periudhën midis shekujve VI dhe VII, në truallin e qytetit të dikurshëm të Krujës (Kroia), u ngritën muret rrethuese, pjesë të të cilave janë të dukshme në disa segmente të kalasë mesjetare. Objektet e datuara nga shek. VI deri në shek. VII (armë, bizhuteri, etj.), të zbuluara në varret e qytetit, dëshmojnë për këtë ndryshim dhe për ndërtimin e qytetit të ri në Kroia.

Gjatë Epokës së Errët (shek. VII-VIII), trekëndëshi Tiranë-Krujë-Lezhë ishte rajoni qendror për ngjizjen etnike të proto-arbërve të hershëm feudalë.

Kruja përmendet si rezidencë peshkopale gjatë shek. IX, kur qyteti ishte nën juridiksionin e Temës së Durrësit. Dokumentet kishtare të nëntorit 879, përmendin Kroi-në (Krujën) dhe peshkopin e saj, Davidin, si pjesëmarrës në sinodin e mbajtur në kishën e Shën Sofisë në Kostandinopojë.

Brenda kështjellës së Krujës ndodhej rezidenca e komandantit të garnizonit të saj dhe guvernatorit bizantin. Kronikat kishtare të shek. XII përmendin peshkopatën e Arbanonit, qendra e së cilës ka të ngjarë të jetë në Krujë. Albanët ishin një popullsi e vendosur nga Mati deri në Krrabë. Në këtë rajon u

ngjiz etnosi arbër që shumë shpejt do të bëhej sundimtari klasik i Arbanonit mesjetar.

Në shekujt që pasuan, Kruja u bë embrioni i principatës së Arbërve. Princat e parë të këtij formacioni, Progoni dhe bijtë e tij Gjini (1198-1206) dhe Dhimitri (1206-1216), ka të ngjarë të kenë pasur selinë e tyre në kështjellën e Krujës. Midis të dyve, Dhimitri u dallua si një sundimtar i fuqishëm dhe kronikat e kohës e quanin atë "Magnus Arhond" - burrë fisnik, princ i Arbërit. Në këtë kohë, veçanërisht pas gjysmës së dytë të shek. XIII, kur administrata e Topiajve u vendos në Krujë, emri i Principatës të Arbanonit u përhap në një rajon të gjerë nga Tivari dhe Prizeni në veri deri në Çamëri në jug. Arbanoni u bë qendra kryesore e një rajoni mesjetar ku u zhvilluan proceset ekonomike, politike dhe kulturore që lindën një identitet kombëtar shqiptar. Sipas një kronike nga viti 1430, (e ruajtur në një dokument të lëshuar nga babai i Skënderbeut, Gjon Kastrioti), "Peshkopata e Krujës"kishte rreth 800 vjet që ishte themeluar dhe ekzistonte si e tillë (Acta 1913-1918, I, 48).

Kështu, Kruja dhe rajoni i saj kanë qenë trojet nukël të formimit të kulturës arbërore. Nuk ishte rastësi që Kruja u bë qendra kryesore e luftës epike të Skënderbeut kundër Pushtimeve osmane dhe emri saj u bë i njohur në të gjithë Evropën e shek. XV si kryeqyteti i mesjetës (Fig. 4).

Bibliographie:

Adhami S. (1970): Recherches sur l'époque de la construction et les principales reconstructions du château fort de Kruja, in "Monumentet", Vol. 1, 87-101.

Ceka N. (1975): L'architecture des villes illyriennes, in "Monumente të Kulturës në Shqipëri", Vol. I, 5-10.

Ceka N. (1982): Processi di trasformazione nell'Illiria del Sud durante il period arcaico, in "Modes de Contact et Processus

de Transformation dans les Sociétés AnciSkills and Tools to the Cultural Heritage and Cultural Tourism Management – II 226-ennes", Actes du colloque de Cortone (24-30 Mai 1980), Collection de l' Ecole francaise de Rome, 203-218.

Demiraj S. H. (1999): Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe, Tiranë.

Hahn J. G. (1854): Albanische Studien, Wien.

Islami S. (1972): Qyteti ilir në Zgërdhesh, in "Iliria", Vol. II, 195-214.

Islami S. (1974): Fouilles archéologiques 1973 à Zgërdhesh – Krujë, in "Iliria", Vol. III, 413-420.

Islami S. (2008): Historia e Ilirëve, përmbledhje punimesh, Tiranë, Toena.

Luka K. (1988): Dëshmi të lashtësisë dhe të shtrirjes së emrit etnik arben/arbër,

Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe kulturës së tij, Tiranë, 287-288.

Praschniker C., Schober A (1919): Archäogische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien.

Thalloczy L., Jirecek C., Sufflay E. (1913-1918): Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, Vol. I, No. 48.

Zgerdhesh and Kruja: Two Cities of Illyrian-Arbëresh Continuity

(Abstract)

The ruins of the Illyrian city discovered at Zgerdhesh are today preserved on the Kakariqit hill, several kilometers south-west of Kruje. Zgerdhesh is a village under the jurisdiction of the Fushe-Kruje municipality. It is renowned throughout the region for its natural beauty: the impressive scenery is dense with olive trees, fruit trees and other resources.

During the years 1969-1973, archaeological excavations directed by Professor Selim Islami brought to light a series of architectural structures from which were generated several conclusions. (Fig. 1-2).

The traces found on the surface of the hill, especially fragments of iron age vessels, show that the city had been developed as a fortified settlement in the proto-urban period (type Gajtan) Zgerdhesh is listed among the proto-urban fortifications of the Near-Adriatic region, along with the Castle of Dorzit, Persqopit in Tirana, Margelliçit in Patos, etc. At the end of the 4th century BC a new city was built here which experienced a surge of development during the 3rd and 2nd centuries BC. (Fig 3). Life in this city continued throughout the 1st century AD, but from the 4th century on, according to the data in the paleo-Christian necropolis, its territory was converted into a cemetery. (S. Islami, Qyteti ilir në Zgerdhesh, Iliria II, Tiranë 1972, 195-214)

Zgerdhesh and Kruje – Two illyrian-arber cities

We inherit an important historic source of evidence about the Albans and their capital city Albanopoli from the Alexandrian geographer and cartographer Claudius Ptolemy (100-178

AD). Among the Illyrian cities in his work "Geographia" he locates Albanopoli at latitude 41°5" and longitude 46° (Ptolemaeus, Geographia, III, 12 (20). As the Bylin tribe had its capital in Bylis, the Amant had Amantian so too did the Albans have Albanopoli.

In the period between the 6th and 7th centuries, in the lands of the past city of Kruje, the surrounding walls were erected, portions of which are evident in some segments of the medieval castle. Objects dated from the 6th to 7th century (weapons, jewelry, etc.) discovered in the graves of the city testify to this change and to the building of the new city in Kruje.

During the dark ages (7th-8th centuries), the triangle of Tirane-Kruje-Lezhe was the central region in the ascent of early ethnic feudal proto-Arbers.

Kruje is mentioned as an episcopal residence during the 9th century when the city was under the jurisdiction of the Theme of Durrës. Church documents of November 879 mention Kroia (Kruje) and its bishop, Davidi, as a participant in the synod held at the church of St. Sophia in Constantinople. Inside the castle of Kruje was the residence of its garrison commander and the Byzantine governor. The 12th century church chronicles mention the bishopric of Arbanon, the center of which was likely in Kruje. The Albans were a population situated from the Mat to Krrabe. In this region was fermented the people who would very quickly become the classic rulers of medieval Arbanon.

In the centuries that followed, Kruje became the embryo of the Arber principate. The first princes of this formation, Progoni and his sons Gjini (1198-1206) and Dhimitri (1206-1216) would likely have had their headquarters in the castle of Kruje. Between the two, Dhmitri distinguished himself as a powerful ruler, and the chronicles of the time of called him "Magnus Arhond" — noble man, prince of Arber. At this time, especially after the second half of the 13th century when the Topai

administration was chosen in Kruje, the name of the Arbanon district was spread throughout a wide region from Tivari Prizeni in the north to the Camierise in the south. Arbanon became the main focus of a medieval region wherein developed the economic, political, and cultural processes that gave birth to an Albanian national identity. According to a chronicle from 1430, (preserved in a document released from the father of Skanderbeg, Gjon Kastrioti) the Bishopric of Kruje at that time had existed for around 800 years. (Acta Alb. I, 48). Thus, Kruje and its region have been the foundational lands of the Arber culture. It was not by chance that Kruje became a main center of Skanderbeg's epic war against the Ottoman invasions and its name became known throughout 15th century Europe as the capital of medieval Arber. (Fig. 4).

X

SPATHEIONE TË DYRRAHUT[1]

Gjatë gërmimeve emergjente të kryera nga Departamenti i Arkeologjisë i Durrësit, gjatë vitit 2005, në lagjen 11 u zbuluan, pjesë të një sektori prodhimi dhe disa ambjente shërbimi të një kompleksi helenistiko-romak.

Kompleksi ndodhet pranë banjove publike romake, përballë Bankës Reifeisen, pak metra larg aksit rrugor që të çon tek Kepi "Pali".

Ndërtesa, aktiviteti kryesor i së cilës ishte prodhimi i terrakotave, ka ekzistuar kronologjikisht, nga shek. IV para Kr. deri në shek. VI mbas Kr. Brenda strukturave të saj u identifikuan tre faza të ndryshme. (Fig. 1)

Në fillimet e fazës së tretë, e cila korrespondon me gjysmën e parë të shek. V, kompleksi u rinovua dhe u zgjerua, duke i lejuar vazhdimin e aktivitetit deri në gjysmën e parë të shek. VI

Koleksioni, me mbi njëzet spatheione, u gjet në njësi stratigrafike në nivele të përafërta (USS: A9, A11, B3, B9, B10, 905, etj.), në një depo, të përdorur për ruajtjen e ushqimit.

Spatheionet janë relativisht të mëdha, me lartësi që variojnë nga 71.5 deri në 90 cm dhe me një diametër të buzës që varion nga 8 deri në 12 cm. Biskoti është tipik i kuqërremtë në rozë,

[1] Marrë nga: Hoti A- Gli spatheia di Dyrrachium, Rei Cretariæ RomanæFavtorvm, Acta 40, Congressvs Vicesimvs Qvintvs Rei Cretariæ Romanæ Favtorvm Dyrrhachii Habitvs Mmvi Bonn 2008, 1-7. ISBN: 978-3-7749-3574-7, ISSN: 0484-3401.
-Ilustrimet grafike përgatitur nga: M. Daljani. Fotot: A. Hoti.

me nuance të verdhë kashte, përzierje të vogla mike, tipare thuajse të njejta me amforat e tjera, spatheia të prodhimit afrikan.



Fig. 1, Durrës 2005 (Pamje e përgjithshme nga gërmimi).
(Foto: A. Hoti).

Karakteristikat kryesore të këtyre amforave janë: një trup i zgjatur cilindrik, i pykëzuar drejt fundit, qafë gjithashtu cilindrike, buzë të trashë, fund i majacuar. dhe vegjë të vogla të

vendosura në qafë. Këto cilësi, përveç të tjerave, duket se imitojnë enë të tilla si Keay XXV ose Tripolitane.

Krahasuar me klasifikimet tipologjiko-kronologjike, të publikuar kohët e fundit nga M. Bonifay (Bonifay 2004, 124-125) rezulton se:

- 4 enë u përkasin tipit 1: varianti A1.

- 11 të tjera u përkasin tipit 31: 5 variantit A3; 5 variantit B8 dhe 1 variantit D19. (Fig. 2)



Fig. 2, Spatheione, tipi 31, A3 (Në kontekstin stratigrafik). (Foto: A. Hoti).

Spatheionet u gjetën në një kontekst stratigrafik të shoqëruar me gjetje të tjera, siç janë: fragmentet e një kandili afrikan (ndoshta tipi Atlas X, grupi C3), prodhuar në Tunizinë qendrore, datuar në gjysmën e dytë të shek. V mbas Kr. (Bonifay

2004, 383, 214, 1-2) (Fig. 3).; amfora të tipit Sinope, të cilat kronologjikisht, i përkasin gjysmës së parë të shek. V mbas Kr.

Si referencë për datimin absolut, kemi amforën e tipit Sinope, e importuar nga një qendër ende e paidentifikuar, por që, në Selanik dhe Liban, është datuar në vitin 410 pas Kr. (Sipas Reynolds në: BEY, 006. 13357. 7). (Fig. 4).




Fig. 3. Fragment i një kandili afrikan (Atlante X, grupi C3). (Foto: A. Hoti)

Enët Spatheione, të gjetura në Scodra (Provinca Prevalitania), Kështjella dhe Qafës (Provinca Epirus Novas), dhe në gjetjet në Onchiasmo dhe Buthrot, pranë bregdetit Jon (Provinca Epirus Vetus), të datuara në fillim të shek. V mbas Kr.,

njihen si objekte që kanë qarkulluar edhe në këto qendra tregëtare (Hoxha 1992, VIII, 1-4; Cerova 1987, VII, 2; 1992, I, 11; Lako 1981, I, 1; 1984, III, 3).

Këto enë, në përgjithësi konsiderohen me origjinë afrikane nga punishte të Tunizisë veriore, siç është Sidi Zahruni pranë Nabeul. Ata ishin prodhues mjaft të njohur, me aktivitet të gjërë që, nga fillimi i shek. V mbas Kr., hodhën në tregun mesdhetar, variacione morfologjike.të larmishme të Spatheioneve

Tek enët Spatheia të Dyrrahut, vetëm në disa ekzemplarë përberja e biskotit identifikohet përfundimisht si afrikane, tek enët e tjera, nuancat e pjekjes ende nuk lejojnë për një identifikim të saktë të përbërjes së tyre. Biskoti i tyre, herë-herë, ndryshon, nga ngjyra e kuqe portokalli në të verdhë kashte. Edhe mika, rëndom paraqitet kompakte, por nuk përjashtohen rastet e plasaritjeve të imta.

Spatheione të këtilla ndeshen në numër të konsiderueshëm në kontekste të ndryshme të qendrave tregëtare italiane dhe në vende të tjera mesdhetare.

Analizat e mikroskopisë optike (Inv. n. 1103, 3955) konfirmojnë të njëjtën hipotezë, të formuluar nga unë, për prejardhjen e spatheionëve të Dyrrahut (shih kontributin nga Claudio Capelli dhe Michele Piazza në shtojcën e këtij artikulli publikuar në: Acta 40, Congressvs Vicesimvs Qvintvs Rei Cretariæ Romanæ Favtorvm Dyrrhachii Habitvs Mmvi Bonn 2008, 1-7).

Aktualisht, nuk është e mundur të identifikohet ndonjë prodhim "lokal" përtej atyre të konfirmuara si enë të Afrikës së Veriut (megjithëse kjo mundësi është hipotezuar në të kaluarën).

Spatheionet, në kontekstet ku janë gjetur, datojnë midis viteve 410 dhe 420 pas Kr., periudhë në të cilën, qeramika afrikane ishte shumë e pranishme në portet dhe qendrat tregtare të provincave jugperëndimore bizantine të Ilirikut (Hoxha 1992,

225-227; Tartari 1982, 261-262: 23; Cerova 1987, 170-171; 1992, 250-251; Lako 1981, 102-104; 1984, 177-180).




Fig. 4. Amfora Sinope, rreth vitit 410 Mbas Kr.

Megjithatë ka të dhëna që, këto enë, u përdorën edhe gjatë periudhës paravandale (Reynolds 1995, 50) dhe më vonë (420-450 mbas Kr.).

Zbulimi i spatheioneve në Dyrrah është dëshmi e tregtisë dhe transportit të produkteve ushqimore si vera, salcat e peshkut, esencat dhe pomadat të çmuara. Qarkullimi i këtyre enëve dëshmon për ekzistencën e një tregu aktiv në ultësirën e Ilirisë jugperëndimore, ku shquhej një port si ai i Dyrrahut, por edhe Aulona, Onchiasmi dhe të tjerë, ende të paidentifikuar.

Katalogu

Tipi 1, A1

1. Biskot rozë-verdhë, me sipërfaqaqe ngjyrë okër (A-9). Ø 11. 5 cm; L 22 cm. Nr. Inv. 314 (Pllaka I, 1). me nuanca okër (A-9). Ø 11. 5 cm; L 22 cm. Nr. i inv. 314 (Tab. I, 1).

2. Biskot kompakt, mikë e kuqërremtë, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-9). Ø 16. 5 cm; L 9 cm. Nr. i inv. 4416 (Tab. I, 2).

3. Biskot i kuqërremtë kompakt, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-9). Ø 10. 5 cm; L 10. 7 cm. Nr. i inv. 4413 (Tab. I, 3).

4. Biskot kompakt, mikë e kuqërremtë, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-10). Ø 12 cm; L 21. 3 cm; Nr. i inv. 4404.

Tipi 31, A3

5. Biskot rozë-verdhë, me sipërfaqaqe okër (A-11). Ø 8 cm; L 19. 8 cm. Nr. i inv. 1103 (Tab. II, 1).

6. Biskot e kuqërremtë, kompakte, me sipërfaqaqe okër (B-9). Ø 9 cm; L 16. 5 cm. Nr. i inv. 4416 (Tab. II, 2).

7. Biskoti kuqërremtë; me sipërfaqaqe okër (B-9). Ø 9. 8 cm; L 70. 5 cm. Nr. i inv. 4409 (Tab. III, 1).

8. Biskoti kuqërremtë; me sipërfaqaqe okër (B-9). Ø 10 cm; L 71. 4 cm. Nr. i inv. 4408 (Tab. III, 2).

9. Biskot kompakt i kuqërremtë; me sipërfaqaqe nuanca okër (B-9). Ø 11 cm; L 16. 8 cm. Nr. i inv. 3955.

Tipi 31, B8

10. Biskot e kuqërremtë, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-3). Ø 9 cm; L 21. 5 cm. Nr. i inv. 730 (Tab. IV, 1).

11. Biskoti i kuqërremtë, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-9). Ø 12 cm; L 25 cm. Nr. i inv. 4405 (Tab. IV, 2).

12. Biskot i kuqërremtë, me sipërfaqaqe nuanca okër (B-9). Ø 11. 5 cm; L 12 cm. Nr. i inv. 4415 (Tab. V, 1).

13. Biskot i kuqërremtë; me sipërfaqaqe nuanca okër (A-9). Ø 8. 5 cm; L 19. 3 cm. Nr. i inv. 905.

14. Biskot kompakt, me sipërfaqaqe të kuqërremtë (B-3). Ø 10 cm; L 19. 5 cm. Nr. i inv. 4414.

Tipi 31, D19

15. Biskot kompakt, me sipërfaqaqe të kuqërremtë (B-9). Ø 11 cm; L 28 cm. Nr. i inv. 4406 (Tab. V, 2)

Bibliografia

Bonifay, M. 2004 Etudes sur la céramique romaine tardive d'Afrique, BAR International Séries 1301.

Cerova, Y. 1987 The castle of Qafë in the region of Sulova "Iliria", 2.

_____ 1992 A new contribution on the amphorae of the castle of Onchesmos, "Iliria", 1-2.

Hoxha, G. 1992 Late Antiquity amphorae from the city of Shkodër of the 5th - beginning of the 7th cent.), "Iliria"1-2.

Lako, K 1981 Fouilles archeologiques 1975-1976 dans la cite de Butrint, "Iliria", 1981, 1.

_____ 1984 The castle of Onhesmos, "Iliria", 2.

Reynolds, P. 1995, Trade in the Westen Mediterranean, AD 400-700: The ceramic evidence, BAR International Series 604.

Tartari, F, 1982, Les amphores du Musee archeologique de Durrës, "Iliria", 2.

GLI SPATHEIA DI DYRRACHIUM

(Astratto)

Durante gli scavi di emergenza effettuati dal Dipartimento di Archeologia di Durrës nel corso del 2005, nel quartiere nr. 11, è stato scoperto una parte del settore produttivo ed alcuni ambienti di servizio di un complesso ellenistico –romano (Fig. 1). Il complesso è posto nei pressi dello stabilimento delle terme pubbliche romane, di fronte alla Reifeisen-Bank a pochi metri dall'asse stradale che porta verso Capo" Pali".

L'edificio, la cui attività principale consisteva nella produzione di terracotta, ebbe una vita, cronologicamente parlando, fra IV ed il VI sec. d. C.; in essa abbiamo identificato le varie fasi che secondo il nostro parere sono tre:

Nella terza fase, che corrisponde alla prima metà del V secolo, il complesso è stato ristrutturato e notevolmente potenziato, fatto che gli ha permesso di continuare la sua attività fino alla prima metà del VI secolo.

La collezione di oltre venti spatheia è stata trovata nelle unità stratigrafiche a livelli approssimativi (USS: A9, A11, B3, B9, B10, 905 etc.), in un magazzino utilizzato për la conservazione dei mezzi di sussistenza.

Gli spatheia hanno dimensioni relativamente grandi, con un'altezza che varia fra 71.5 e 90 cm e con un diametro dell'orlo che varia tra 8 e 12 cm. Tipica è l'argilla di colore rossastro e rosato, ad impasto giallo paglia con piccoli inclusi micacei, simili ad altre anfore Spatheia di produzione africana. Le caratteristiche principali di queste anfore sono: il corpo fusiforme, allungato, collo cilindrico, orlo semplicemente ingrossato o realizzato ad imitazione di altri contenitori, come

Keay XXV o tripolitane, fondo con piccolo puntale, piccole anse a maniglia impostate sul collo.

Da un confronto di classificazione tipologico-cronologica che è stato fatto ultimamente da M. Bonifay(Bonifay 2004, 124-125) risulta che:

- 4 appartengono al tipo 1: alla variante A1.
- 11 appartengono al tipo 31: 5 alla variante A3 (Fig. 2); 5 alla variante B8 e 1 alla variante D19.


Gli spatheia sono stati trovati in un contesto stratigrafico associato ad altri reperti, come frammenti di una lucerna africana (forse tipo Atlante X, gruppo C3), (Fig. 3), prodotto di Tunisia centrale, datato alla seconda metà del V secolo (Bonifay 2004, 383, 214, 1-2); anfore del tipo di Sinope, etc. che cronologicamente appartengono alla prima metà del V sec. d.C. Come referente per la datazione assoluta, abbiamo un' anfora di tipo Sinope (Fig. 4), importata da un centro non ancora identificabile, ma che a Thessalonica ed in Libano vie-ne datata al 410 d. C. (Secondo Reynolds in: BEY, 006. 13357. 7).

Generalmente si ammette un'origine africana per questi contenitori (quelli della fornace della Tunisia settentrionale, ad esempio Sidi Zahruni, presso Nabeul, attiva probabilmente dall'inizio del V secolo, presentano una gamma diversificata di varianti morfologiche.


Analisi in microscopia ottica confermano la stessa ipotesi, formulata da me, anche për quando riguarda i spatheia da Dyrrachium, (v. il contributo di Claudio Capelli e Michele Piazza in questo articolo come appendice, (Inv. n. 1103, 3955). Allo stato attuale non è possibile individuare eventuali produzioni "locali" oltre a quelle nord africane accertate (ma l'eventualità e stata in passato ipotizzata).

Inoltre, questi recipienti hanno trovato utilizzo anche durante il periodo pre vandalo (Reynolds 1995, 50), e in seguito


(420-450 d. C.). Il ritrovamento di questi spatheia a Dyrrachium è una testimonianza di scambi commerciali e del trasporto di prodotti alimentari come vino, salse di pesce, essenze e unguenti preziosi.




TAB. I. Tipi 1, A1.




TAB. II. Tipi 31, A3.



TAB. III. Tipi 31, A3.




1




2

TAB. IV. Tipi 31, B8.



1



2

TAB. V. Tipi 31, B8 (n. 1), D19 (n. 2).

XI

TË DHËNA ARKEOLOGJIKO-HISTORIKE PËR DYRRACHIUMIN GJATË SHEK VII-IX.[1]

Gërmimet arkeologjike të kryera gjatë dekadave të fundit në kala, në amfiteatër, në Macellum e gjetkë, kanë nxjerrë në dritë materiale të mjaftueshme, për të ndriçuar aspekte të ndryshme socio-ekonomike dhe kulturore të komunitetit të Dyrrachiumit midis shekujve VII dhe IX.

Ashtu siç ndodhi me qytetet bizantine në Ballkan dhe në Azinë e Vogël, Dyrrahu, pas mesit të shek. VII, përjetoi një rënie ekonomike dhe kulturore. Ky fenomen u nxit, jo vetëm nga dobësimi i ndjeshëm i lidhjeve politike dhe ekonomike me Bizantin, por edhe nga shkaqe natyrore që, me gjasë shkaktuan një tkurrje demografike[2].

Zvoglimi i pjesës më të madhe të qendrës urbane të periudhës së hershme kristiane dhe shndërrimi i saj në zonë varrimi, u shoqërua me një pakësim të objekteve të përdorimit të përditshëm. Kjo prirje konstatohet, jo vetëm te inventari i varfër i varreve, por edhe te shtresat arkeologjike të depozituara në

[1] Marrë nga: Hoti A. Dati storici-archeologici për il Durrachium durante il VII-IX secolo. New Archaeological Discoveries in the Albanian Regions International Conference në Akademinë e Shkencave (Albanian Academy of Sciences), Tiranë, 30-31 Janar 2017. ("Procedings of the International Conference New Archaeological Discoveries in the Albanian Regions" II, Tiranë 2017. f. 723-732

[2] Hoti 1996, p.179.

rrënojat e amfiteatrit, Macelumit dhe monumenteve të tjera, të zbuluara në Durrës[3].

Muret mbrojtëse të periudhës paleobizantine (që fillimisht përfshinin një sipërfaqe prej 110 hektarësh), pësuan një reduktim të ndjeshëm, duke u tkurrur në një të tretën e sipërfaqes së tyre të mëparshme. Nga fundi i shek. VII, kompleksi episkopal, Macellumi dhe disa ndërtesa të tjera humbën funksionin e tyre dhe u shndërruan në varreza. Vetëm disa ndërtesa të antikitetit të vonë mbetën në përdorim: kapela A, një ndërtesë e shekullit VI në anën jugore të amfiteatrit, kisha e Anargjirëve (e përmendur në një dokument të vitit 714) dhe disa banesa të tjera[4].

Kjo periudhë krize u shoqërua me një rënie të qarkullimit monetar dhe të artikujve të importuar. Kronologjikisht, gjetjet e rralla numizmatike të zbuluara në Durrës përbëhen nga prerje: të Mauric Tiberus (582-602), 1 copë; Focas (602-610), 6 copë; Herakliu I (610-641), 1 copë; Konstanci II (641-668), 6 copë dhe Konstanti IV Pogonatus (654-685), 1 copë[5].

Megjithatë, edhe pse ndërprerja e qarkullimit monetar solli një gjendje kolapsi në ekonomi, duke iu referuar gërmimeve arkeologjike dhe burimeve historike, në aktivitetin prodhues të qytetit, vërehet njëfarë vazhdimësie me ritme të ulëta[6].

Nga dekadat e para të shek. VII e deri në prag të krijimit të Themës, për një periudhë prej më shumë se dy shekujsh, në ndërtesat e qytetit u kryen një sërë përshtatjesh dhe rindërtimesh.

[3] Hoti 1996, p.179. Toçi 1971, p.39-40; Tartari 1984, 227-250; Hoti1987, p. 261- 262; Hoti 1989, p.243-244; Miraj 1991: p.47-57, Hoti et al. 2004b, p.409, 508-509, 516, 519; Hoti et al. 2008, p.373fig.4, p.375, fig.5, p380.
[4] Hoti 1996, p.178.
[5] Hoti - Myrto, 1991, p.101-105.
[6] Hoti 1996, p.179.

Si pjesë e ristrukturimit urban të qytetit bizantin, zona e amfiteatrit, e braktisur më parë dhe e shndërruar më pas në një vendvarrim, pësoi ndryshime të mëtejshme[i7]. Përveç Kapelës, prania e një banese në skajin jugor të monumentit, e zbuluar gjatë gërmimeve të fundit arkeologjike italo-shqiptare, tregon se vetëm një pjesë e kufizuar e sheshit, ku ndodhej dikur amfiteatri, përdorej për banim, ndërsa pjesa më e madhe e territorit të tij, ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme funerare të krishterë[8]

Sa u përket praktikave të varrimit në amfiteatër, vihet re se, në dallim nga traditat pagane, përfshirja e objekteve shoqëruese në varre bëhet gjithnjë e më e kufizuar (nga18 varre të zbuluara, mesatarisht vetëm njëri përmbante sende të tilla). Ndër të paktat objekte të gjetura në varre janë disa vëthë, unaza dhe togëza të shek, VII-VIII[9]

Në kushtet e situatës së re, politika e bashkëjetesës e hartuar nga perandori Herakli, e veçanërisht dhënia e së drejtës së vetëqeverisjes dhe autonomisë për disa provinca, si dhe paqja e lidhur nga perandori Konstandini IV, me mbretërinë lombarde në vitin 680, krijuan premisa që nxitën riorganizimin administrativ të rajonit jugperëndimor të Ballkanit[10]. Në këto rrethana u krijua, Arkondati i Dyrrahut, si një formë vetëqeverisjeje për qytetin dhe rajonin përreth.

Arkondati i Durrësit, i formuar në gjysmën e dytë të shek. VII, kishte nën juridiksionin e tij një territor të kufizuar, me kufij tokësorë e detarë konvencional (Dyrrhachion, Plistum, Kroia...?).

Kronikat e kohës dëshmojnë se, gjatë viteve 765–770, në detin Adriatik vihet re një prani e dukshme e flotës bizantine, e

[7] Toçi 1971, p.39-40. Miraj 1991, p.47-57.
[8] Ibidem.
[9] Hoti-Komata 2004a, p.176, fig.7:4.
[10] Treadgold 1997, p.303, 320-321, 377.

cila përdorte si strehë dhe bazë mbështetëse portin e Dyrrahut dhe strukturat administrative vendore të Arkondatit.

Siç dëshmohet nga mbishkrimet në medaljone, mbrojtja e qytetit sigurohej nga trupa ushtarake. Milicia qytetare ishte një regjiment i drejtuar nga Arkondi, i mbështetur nga autoriteti kishtar i Dyrrahut. Midis viteve 775 dhe 780, Arkondati mbrohej nga një garnizon prej 100 ushtarësh, një forcë e krahasueshme me ato të Arkondateve të Kefalonisë, Selanikut, Kretës, Qipros dhe Khersonesit. Vetëm Siçilia dhe Kalabria kishin kontingjente më të mëdha trupash, pasi në atë kohë gëzonin statusin e Themës[11].

Gjatë shekujve VII dhe VIII, Durrësi dhe rajoni përreth tij, i njohur me emra si Dyrrakia dhe Dysrrakia, konsideroheshin si qendra kryesore urbane dhe bazë jetike ushtarake bizantine në bregdetin e Adriatikut[12]. Në atë kohë, rajoni fqinjë jonik i Vagenetisë, pavarësisht se zotëronte disa atribute të një Arkondati dhe shërbente si nyje detare, mbeti në varësi të Durrësit[13].

Sipas të dhënave arkeologjike varreza zinte pjesën më të madhe të hapësirës së amfiteatrit. Për ndërtimin e kishave dhe të varreve, krahas ripërdorimit të tullave dhe tjegullave të Antikitetit të Vonë, punishtet e qeramikës futën në treg një sërë produktesh të reja. Kështu, dyshemeja e Kapelës në amfiteatër u shtrua me tulla me përmasa 35 x 27 x 4.5 cm[14], ndërsa për mbulimin e strukturave të varreve u përdorën tjegulla me përmasa: 54 x 21cm[15].

[11] Hoti 2014, 89.
[12] Santoro - Hoti – Sassi 2006, p.728.
[13] Hoti 1990, p.106, nr.17, tab. XXXII, 9.
[14] Hoti 1990, p.109, nr.17, tab. XXXIV, 8.
[15] Santoro et.al. 2006, p. 728



Fig 1a



Fig 1b

Fig. 1a. Durrës: fragment i një pilastre lombarde.
(fundi i shek. VIII - fillimi i shek. IX). (Foto A. Hoti)

Fig. 1b. Durrës: fragment i një arkitrau lombarde
(fundi i shek. VIII - fillimi i shek. IX). (Foto A. Hoti)

Monogramet e gjetura mbi tulla, si dhe simbolet me përmbajtje të krishterë (kryqe, elemente të eukaristisë etj.), dëshmojnë për rolin e shtetit dhe të kishës si defensor civitatis.

Analiza e të dhënave arkeologjike dhe e burimeve historike, ka bërë të mundur identifikimin e një sërë dukurish lidhur me veprimtarinë ekonomike të kësaj periudhe.

Për të përmbushur nevojat e qyteteve bizantine të Arkontisë dhe të Themës, importi i mallrave artizanale bizantine vazhdoi gjatë shekujve VII–IX, si përmes rrugëve detare, ashtu edhe përmes Via Egnatias.

Nga tregjet perandorake vinin zbukurime të ndryshme si fibula, togëza rripi, karfica, medaljone, varëse dhe stoli të tjera tipike për artin e argjendarisë ballkano-bizantine[16].

[16] Ballardini 2008, p.141 Fig. 164-166 - Roma, Museo Nazionale Romano, Crypta Balbi. Frammenti di architrave di pergula da Santa Martina;Ducci 2013, p.68-69, Fig. 7- Pavia, Musei Civici del Castello Visconteo: pilas-trino proveniente dalla chiesa di San Pietro in Ciel d'Oro.

Produktet e importuara gjatë shekujve VII–IX, me origjinë nga qendrat e prodhimit dhe të tregtisë në Mesdhe, përfaqësohen në Dyrrah nga disa kategori produktesh:

1. Elemente të skulpturës arkitektonike dekorative, të porositura nga Papati në punishtet lombarde të Italisë, për ndërtimin e kishave. (Fig. 1a-b). Është fakt i mirënjohur se kishat dhe bazilikat e Dyrrahut përmbajnë një sërë elementesh të skulpturës arkitektonike të importuara drejtpërdrejt nga punishtet lombarde në Itali (pa përjashtuar mundësinë që këto elemente të jenë riprodhuar në punishtet lokale, bazuar në modelet e origjinës).

